

Pirro Arapi

NËNDORI

REVISTË

LETRARE · ARTISTIKE, SHOQËRORE · POLITIKE

11

1956

Çmimi lek 30

NENDORI

REVISTË E PËRMUAJSHMË
LETRARE — ARTISTIKE
SHOQËRORE — POLITIKE
(Viti III i botimit)

Nr. 11 - Nëntor 1956

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE
ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

LE N D A

	Faqe
Pesëmbëdhjetë vjet nën udhëheqjen e Partisë	3
Këshilli i Ministrave vendos krijimin e konditave më të mira për punë krijuese të shkrimtarëve dhe artistëve	6
Krijimi i organizatës së përbashkët "Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë"	7
BAJRAM HYSENI Partisë — Buzë Adriatikut, vjersha	19
ALQI KRISTO Moskës, vjershë	20
PIRO TAKO Njerëz të ditëve tona! tregim	21
NAZMI QAMILI Pranvera në familjen e madhe . — Ku e ardhmja troket! . — Tek një krue vjersha	49
BEHEXHET ÇERMA Rishmezi, vjershë	50
MURAT NEXHA Shoqes drenovare — Ç'po lulëzon kajsia — Një xhura po bije, vjersha	51
BILBIL KLOSI Në Hekal, përshkrim	52
KUJTM HOXHA Kthimi, vjershë	78
KUJTIME NGA LUFTA NACIONAL ÇLIRIMTARE	
MYSLIM CANAJ Jeta e Zonjës Çurre	81
Përvjetorët e instituteve Pedagogjike	99
PROBLEME LETRARE	
RAZI BRAHIMI Figura e komunistit në letërsinë tonë	10
KRITIKË LETRARE	
BEDRI DEDJA Mbi poemën «Mësuesi» të Lllazar Siliqit	127
KRITIKË SOVJETIKE	
A. EGOROV Mbi veçoritë kombëtare të artit	144
A. DEMENTIEV Diskutim në Poloni rreth letërsisë sovjetike	165

Ekspozita e arteve figurative sovjetike në Shqipëri — Sukses i artistëve të rinj në Teatrin tonë popullor — Përkujtohet 350 vjetori i lindjes së piktorit të madh hollandez Rembrand Van Rijn — Mbledhje kushtuar 20 vjetorit të vdekjes së shkrimtarit të madh kinez Lu Sin — Një piktor gjerman në vëndin tonë — Shkrimtari Sterjo Spasse në R. P. të Kinës dhe në R. P. të Mongolisë — Për zgjerimin e lëvizjes artistike diletante në radhët e puntorëve — Sukses i madh i grupit të baletit të Teatrit Balshoi në Angli — Zgjerimi i lidhjeve midis shkrimtarëve sovjetikë dhe të huaj — Dekada e kulturës ukrainase në Poloni — Në Moskë u hap një ekspozitë mbi historinë e artit dhe të letërsisë së Egjiptit — Në Bashkimin Sovjetik filloi festivali i dytë i filmave indianë — Presidenti i Republikës së Libanit Gamil Shamur priti delegacionin e artistëve sovjetikë, Vizatime dhe piktura të fëmijëve kinezë në R. D. Gjermane — Artistët kinezë korrin sukses të madh në Argjentinë — Pritje për nder të delegacionit francez të kinematografisë në Kinë — Në Poloni filloi festivali i parë i muzikës moderne «Vjeshta e Varshavës» — Në Berlin u hap festivali i filmave të vëndëve të Demokracisë Popullore — 10 vjetori i rihapjes së konservatorit të Lajpcigut.

JUP KASTRATI — Bibliografi letrare shqipe

Libra të reja.

Pesëmbëdhjetë vjet nën udhëheqjen e Partisë

Pesëmbëdhjetë vjet më parë, më 8 nëndor 1941, në një shtëpi të vogël në Tiranë u themelua Partia Komuniste (tani Partia e Punës e Shqipërisë) — udhëheqësia e lavdishme e popullit tonë në luftë për çlirimin e Atdheut e për ndërtimin e socializmit në vëndin tonë. Gjatë jetës së saj Partia jonë ka përshkuar një rrugë plot heroizma të pashëmbullta në luftë kundër imperialistëve okupatorë dhe armiqve të brëndshëm — shërbëtorëve të fashizmit e t'agjenturave të huaja imperialiste.

Qysh në ditët e para të jetës së saj Partia u vu me vendosmëri në krye të revolucjonit popullor, dhe e udhëhoqi atë me urtësi duke u mbështetur kurdoherë në mësimet jetdhënëse të marksizëm-leninizmit mbi kryengritjen e armatosur e mbi format e luftës së klasëve në periudhën e lëvizjeve nacional-çlirimtare. Me vijën e saj të drejtë politike e me veprimtarinë praktike gjatë periudhës së luftës partia grumbulloi rreth vëhtes gjithë masat punonjëse të vëndit dhe krijoi kështu frontin e pashëm të popullit kundër okupatorëve dhe qeverive tradhëtare të bejlerëve e të borgjezisë reaksionare.

Populli ynë, që gjatë gjithë historis së tij ka luftuar kundër agresorëve, okupatorëve dhe intrigave imperialiste, për herë të parë gjeti një udhëheqës të sprovuar dhe besnike, që luftonte për të, për jetën e tij, për lirin e tij, për t'ardhmen e tij të lumtur. Flamuri i kuq i Partisë u bë simbol i luftës për çlirim kombëtar, ekonomik dhe shoqëror, flamur i paqës dhe i miqësisë me gjithë popujt e botës, flamur i madh i betejave ngadhënjimtare për çdukjen e çfrytëzimit të njeriut nga njeriu e për ndërtimin e shoqërisë socialiste në vëndin tonë.

Të shumta janë shëmbullat e të panumurta dokumentat që flasin për historinë e lavdishme të Partisë sonë të Punës, e po kaq të shumtë janë edhe bijt e saj të mrekullushëm që falën jetën e tyre në barikatat partizane, në betejat për çlirimin e vëndit. E ashpër ishte lufta, të egjër e të fortë ishin armiqt, po as hekuri, as zjarri, as burgjet, kampet e përqëndrimit e trikëmbëshat nuk mundën ta përkulin vullnetin e popullit tonë për të qenë i lirë.

Populli ynë ishte i sigurtë për fitoren mbasi ai kishte në krye Partinë e lavdishme të komunistëve që i ndriçonte rrugën me dritën e shkëlqyer të marksizëm-leninizmit e që e lidhi në miqësi me popujt vëllezër të Pashkimit Sovjetik, flamurtarit të luftës kundër fashizmit, Atdheut të parë të socializmit ngadhënjimtar. Populli ynë ishte i sigurtë në fitore mbasi krah për krah me të luftonin gjithë popujt e robëruar nga fashizmi dhe gëzonte simpatinë e gjithë njerëzimit përparimtar. Dhe ai fitoi. Më 29 nëndor 1944 Shqipëria u çlirua një herë e përgjithmonë nga okupatorët e huaj.

Më 1944 filloi për popullin tonë një epokë e re, epoka e historis së vërtetë njerëzore, epoka e jetës së lirë socialiste. Edhe në këtë luftë ndërtimtare në krye të popullit tonë punëtor e paqëndashës valvitej po ai flamur — flamuri i Partisë, nën udhëheqjen e së cilës gjatë këtyre dy-mbëdhjetë vjetëve të fundit janë arrijtur suksese të mëdha në ndërtimin

e vëndit, në zhvillimin e tij ekonomik e kultural, në transformimin e tij socialist. U rindërtuan urët, rrugët, fshatrat e shtëpitë e djegura, fabrikat dhe minierat e shkatruara, shkollat e prishura dhe u normalizua ekonomia e vëndit që ishte dëmtuar rëndë nga okupatorët fashistë. Krahas këtyre u zbatuan një sërë reformash të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore si reforma agrare, që zhduku mbeturinat e feodalizmit, shtetëzimi i tregëtisë së jashtme e tregëtisë së brendshme grosiste, shtetëzimi i ndërmarrjeve kapitaliste e i bankës, krijimi i sektorit shtetëror e kooperativist në tregëti, reforma arsimore etj. U krijua sektori i ekonomisë socialiste, e cila u vu në rrugën e zhvillimit të planifikuar dhe tani përfaqëson përqindjen më të madhe të t'ardhurave tona kombëtare.

Dymbëdhjetë vjet kanë kaluar që nga dita e çlirimit, e, megjithëse koha është relativisht e shkurtër, fitoret e popullit tonë janë shumë të mëdha si n'ekonomi ashtu edhe në kulturë. Realizimi me sukses i planit të parë pesëvjeçar (1950-1955) dhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar (1955-1960) që u aprovuan në Kongresin e III të P.P.SH. i hapin vëndit tonë perspektiva të reja të shkëlqyeshme për ritjen e mëtejshme të mirëqenjes materiale dhe kulturele të masave punonjëse.

Gjatë planit të parë pesëvjeçar vëndi ynë arriti suksese të mëdha në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik e kultural. Në krahasim me 1950, vit i parë i pesëvjeçarit të parë, më 1955 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial arriti në 179% dhe 10,5 herë më shumë se më 1938. Gjatë periudhës 1950-1955 vëllimi i transportit automobilistik të mallrave arriti 263%, transporti hekurudhor 222% dhe transporti detar 160%, kurse numri i pasagjerëve arriti në 802%.

Suksese të konsiderueshme gjatë planit të parë pesëvjeçar arriti edhe bujqësija, prodhimet e së cilës më 1955 u rritën në krahasim me 1950 sipas përqindjeve të më poshtëme: drithrat e bukës 153, pambuku 177, panxhari 1179, duhani 432, perimet e patatet 164. Një pjesë e mirë e ekonomive bujqësore u kolektivizuan dhe në shumë fshatra filloi jeta e re në kooperativat bujqësore, numri i të cilave vetëm gjatë vitit 1955 u rrit 87% në krahasim me 1950-tën.

Krahas përmirësimit ekonomik të jetës Partia gjithmonë i ka dhënë rëndësi të madhe edhe rritjes së nivelit kultural të masave punonjëse dhe veçanërisht edukimit të brezit të ri, me botkuptimin materialist-dialektik dhe me normat e larta të moralit komunist. Në vitin e fundit të pesëvjeçarit të parë ndiqnin shkollat fillore, shtatëvjeçare, të mesme dhe të larta 89 mijë djem e vajza t'Atdheut tonë. Gjatë pesë vjetëve (1950-1955) në institutet dhe shkollat pedagogjike u përgatitën 2000 kuadro kurse 2200 të tjera kaluan në kurse kualifikimi.

Në planin e dytë pesëvjeçar sukseset do jenë akoma më të mëdha. Industria jonë e re do marrë një zhvillim akoma më të madh; do zgjerohet e do modernizohet sidomos industria e minierave e do ngrihen mjaft fabrika të reja.

Plani i dytë do jetë pesëvjeçari i modernizimit dhe kolektivizimit të bujqësisë. Më 1960 do kolektivizohen plotësisht zonat fushore dhe një pjesë e mirë e zonave kodrinore e po në këtë vit numri i traktorëve me 15 kuaj fuqi do arrijë 212% në krahasim me vitin 1955. Populli do furnizohet me më tepër prodhime bujqësore e industriale ndër të cilat: sheqer 39% më shumë se në vitin 1955, yndyrna 45%, makarona 37%, mish e peshk 81%, djath e gjizë 264%, fasule e oriz 60%, perime e patate 93%, qumësht 195%, tekstile të pambukta 21%, tekstile të leshta 35%, këpucë e opinga 79%, kadife e drile 379%.

Do rritet numri i shkollave e i institucioneve kulturele në të gjithë vëndin. Në shkollat fillore, shtatëvjeçare e të mesme do mësojnë 249.000 nxënës ose 59.000 më shumë se më 1955, në shkollat e larta do vazhdojnë studimet 3000 studentë, ose 31% më shumë se më 1955 dhe 80% e nxënësve që mbarojnë shkollat fillore do vazhdojnë shkollat shtatëvjeçare.

Nën udhëheqjen e urtë e largpamëse të Partisë, populli ynë për të parën herë në historin e tij mijëvjeçare u bë zot i fateve të veta. Ay ngriti pushtetin e tij politik, pushtetin e demokracisë popullore, i cili krijoi mundësitë që energjitë e pashtershme revolucionare dhe ndërtimtare të masave punonjëse të gjejnë zhvillim të plotë. Nën udhëheqjen e Partisë u realizua aleanca e klasës sonë puntore me fshatarsinë punonjëse, aleancë kjo që vjen përherë duke u forcuar dhe që është baza e pushtetit tonë të përparuar demokratik. I frymëzuar dhe i prirë nga flamuri ngadhënjimtar i marksizëm-leninizmit, nga idealet më fisnikë e njerëzorë, populli ynë është duke çelënikosur përherë më shumë unitetin moral-politik, dhe i grumbulluar si një trup i vetëm rreth Partisë dhe Qeverisë së tij popullore marshon i sigurtë drejt së ardhmes gjithëmonë më të lumtur e më të begatëshme. Rritja e vazhdueshme e prestigjit ndërkombëtar të Republikës sonë, respekti dhe dashuria që gëzon populli ynë jashtë kufijve të Atdheut, vendi i merituar që ze sot Shqipëria në botë, në gjirin e popujve përparimtarë e paqedashës, janë meritë e Partisë sonë, e cila si timoniere e sprovuar e ka drejtuar dhe e drejton popullin tonë në rrugën e mirëqenjes e të nderit. Dhe këtu duhen kërkuar faktorët e sukseseve të pakrahasueshme e historike të arritura në Atdheun tonë gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve nën udhëheqjen e Partisë, e punës plot entuziazëm e vetmohim të klasës sonë punëtore e masave punonjëse të qytetit e të fshatit, krijonjëset e vërtetë të gjitha vlerave morale e materiale të popullit dhe kombit tonë.

Gjatë dymbëdhjetë vjetëve të pushtetit popullor në vëndin tonë kanë marrë një zhvillim të madh edhe letërsia, arti dhe shkenca. Partia përherë e më shumë është kujdesuar për krijimin e konditave më të mira për punonjësit e artit dhe të shkencës dhe i ka orientuar ata vazhdimisht që të kenë burim frymëzimi për veprat e tyre jetën e popullit tonë, luftën e tij të lavdishme kundër okupatorëve, përpjekjet e tij për ndërtimin e socializmit, miqësinë e pathyeshme me popujt e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore si dhe me gjithë popujt e botës që luftojnë për paqën e për një jetë më të mirë.

Vendimi i fundit i Sekretariatit të K.Q. të P.P.SH. dhe i Këshillit të ministrave të R.P.SH. janë një dëshmi tjetër e kujdesit atror të Partisë për punonjësit e letërsisë e t'artit, të cilët i kanë dhënë dhe do t'i japin popullit vepra me vlerë.

Të gjitha këto suksese dëshmojnë se vija politike dhe politika ekonomike e Partisë sonë të Punës kanë qënë të drejta dhe kanë përfaqësuar gjithënjë interesat jetike të masave punonjëse të vëndit tonë.

Sivjet duke festuar pesëmbëdhjetë vjetorin e lavdishëm të themelimit të saj të gjithë punonjësit e Shqipërisë thërrasin me gjithë zëmër:

Lavdi për ty, Parti!

Këshilli i ministrave vendos krijimin e konditave më të mira për punë krijuese të shkrimtarëve dhe artistëve

Që të krijohen kushte për një punë krijuese më të mirë në t'ardhmen për shkrimtarët dhe artistët e vendit tonë, duke marrë parasysh edhe rekomandimin mbi këtë çështje të Sekretariatit të Komitetit qendror të PPSH. Këshilli i ministrave vendosi ta aprovojë krijimin e organizatës së shkrimtarëve dhe artistëve: «Lidhjen e shkrimtarëve dhe t'artistëve të Shqipërisë», në vend të «Lidhjes së shkrimtarëve» dhe «Lidhjes së artistëve».

Vendimi parashikon që antarët e «Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë» — shkrimtarët, kompozitorët, piktorët e skulptorët, që punojnë në aparatën e tij, në organet e tij letrare, në institucionet shkencore e shoqërore, në sektorin e shtypit e të radios, përveç antarëve që punojnë si përkthyes, të kenë një orar të reduktuar prej 4-6 orësh pune në ditë, ndërsa antarët e bashkimit që punojnë në arsim të kenë një normë mësimi gjer në 12 orë në javë.

Parashikohet gjithashtu krijimi i një fondi të ndihmës për letërsinë e artet nga kuotizacionet e antarëve dhe kandidatëve të bashkimit, nga kontributi prej 3 përqind mbi shumën që meret nga antarët dhe kandidatët për të drejtën e antarit për vepra letrare artistike, për çfaqjet publike origjinale, fitimet në konkurset letrare artistike, nga 5 përqind mbi çmimet e Republikës që marrin antarët, nga e drejta e autorit për veprat e rilindasve, të shkrimtarëve dhe artistëve që nuk lënë trashigimtarë, nga subvencionet vjetore të shtetit, të cilat të mos kalojnë më shumë se 2 milion lekë në vit, si dhe nga t'ardhurat që mund të sigurojë vetë Lidhja në mënyrë të tjera, për të pasuruar fondin e tij si librari, punishte artistike për buste, etj.

Me krijimin e këtij fondi nuk do të ketë më shërbime krijuese me pagë nga qendra e punës. Shërbimet krijuese, që do të jenë nga 1 gjer në 3 muaj, dhe në raste të jashtëzakonshme gjer në 1 vit, do të jepen kur antarët shkojnë posht për të mbledhur materiale. Gjatë kësaj kohe antarët do të shpërblehen nga fondi i Lidhjes me 7000-10000 lekë në muaj, sipas nevojave, pavarësisht nga paga që kanë si nëpunës. Ata do të marrin njëkohësisht triskat e ushqimit që kanë patur.

Vendimi i Këshillit të ministrave parashikon që antarët e Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, përveç lejes prej 12 ditësh, të gëzojnë edhe një leje plotësuese prej 12 ditësh në vit.

Porositet komiteti ekzekutiv i k.p. të Tiranës t'u sigurojnë antarëve të Lidhjes strehim normal dhe dhomë plotësuese pune, si dhe një ndërtesë të përshtatëshme për të vendosur aparatën e tij dhe për ta përdorur për klub.

Ai bën fjalë gjithashtu për parashikimin e fondeve nga ana e dikastereve dhe institucioneve të tjera shtetërore për të blerë veprat artistike të piktorës e të skulpturës.

Krijimi i organizatës së përbashkët «Lidhja e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë»

Më 11 tetor u organizua në Tiranë një mbledhje e gjerë e shkrimtarëve, skulptorëve, piktorëve dhe kompozitorëve të vendit tonë, për të diskutuar rreth vendimit të Këshillit të Ministrave të R.P. të Shqipërisë mbi kushte më të mira për punën krijuese të shkrimtarëve dhe artistëve.

Në mbledhje ndodheshin sekretarja e Komitetit qendror të partisë shoqja Liri Belishova, sekretari i parë i komitetit të P.P. së Shqipërisë për Tiranën shoku Rapo Dervishi dhe të ftuar të tjerë.

Mbledhjen e çeli shoku Foto Stamo. Ay tha:

«Më 8 gusht dhe më 9 shtator të këtij viti, Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë së punës së Shqipërisë dhe, pastaj, Këshilli i Ministrave të Republikës popullore të Shqipërië, muarën nga një vendim të rëndësishëm mbi organizimin e shkrimtarëve dhe t'artistëve dhe për të krijuar këndita më të mira për punën tonë krijuese. Komitetet drejtonjëse të Lidhjes së shkrimtarëve dhe të Lidhjes s'artistëve, u mblodhën javën e kaluar për t'u njoftuar mbi këto vendime dhe për të marrë masat e nevojshme që ato të vihen në zbatim. Në vendimet e tyre, Sekretariati i Komitetit qendror të Partisë dhe Këshilli i Ministrave, u rekomandojnë shkrimtarëve dhe artistëve që të krijojnë një organizatë të përbashkët. Komitetet tona drejtonjëse, në mbledhjen e tyre të fundit, e aprovuan njëzëri këtë rekomandim. Ato zgjodhën kështu një komision që të përgatisë sa më parë mbledhjen e përgjithëshme të shkrimtarëve dhe t'artistëve këtu në Tiranë, mbledhjen tonë të sotme, ku anëtarët e të dy organizatave tona të punojnë vendimet e Sekretariatit të Komitetit qendror të Partisë dhe të Qeverisë, ku të bëhet shpërndarja e organizatës së Lidhjes së shkrimtarëve dhe të Lidhjes s'artistëve, dhe të krijohet organizata e përbashkët e shkrimtarëve dhe e artistëve të Shqipërisë. Komitetet tona drejtonjëse dhe komisioni i ngarkuar prej tyre për të përgatitur këtë mbledhje, janë të sigurtë se vendimi i Sekretariatit të Komitetit qendror të Partisë dhe i Qeverisë për krijimin e një organizate të përbashkët të shkrimtarëve dhe t'artistëve të Shqipërisë, është edhe dëshira e masës së shkrimtarëve dhe artistëve tanë. Më lejoni, që në emërin tuaj, të shpreh këtu falënderimet e mi rënjohej e shkrimtarëve dhe t'artistëve për kujdesin e madh që tregojnë vazhdimisht për ta Partia dhe Qeveria. Më lejoni gjithashtu të falënderoj, n'emërin tuaj, gjithë shokët që na nderojnë me prezencën e tyre në këtë mbledhje të rëndësishme për jetën e letërsisë dhe të arteve tona të reja.»

Pastaj, si u zgjodh presidiumi dhe u aprovua rendi i ditës, shoku Foto Stamo ia dha fjalën Shokut Dhimitër Shuteriqi, i cili foli n'emër të komisionit përgatitor të mbledhjes.

FJALA E SHOKUT DHIMITËR SHUTERIQI

Të dashur shokë. Dita e sotme, për jetën tonë letrare dhe artistike, është një ditë e shënuar, dita e një shteti shumë të gëzueshëm. Duke çmuar rritjen e letërsisë dhe t'arteve tona të reja, punën e gjertanishme t'artistëve dhe të shkrimtarëve, pjekurinë që kanë fituar talentet, premtimin që japin për nesër rezultatet e arritura prej nesh, duke çmuar gjith kë-

to, Partia jonë e Punës dhe Qeveria e Republikës krijojnë për ne disa kushte të reja të favorshme. Këto kushte përmblihen në pak fjalë këstu: zbritje t'orarit të punës për shkrimtarët dhe artistët, kudo që ata punojnë; krijim i një fondi të ndihmës për letërsinë dhe artet; shpërblime më të mira për prodhimet letrare dhe artistike, dyfishim të lejes së pushimit vjetor etj.

Unë shokë nuk do të zgjatem për të komentuar këtë vendim, që, pa dyshim, do të bëhet një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm t'arteve dhe të letërsisë në vendin tonë. Ky vendim karakterizohet nga një kuptim i drejtë i nevojave dhe i mundësive tona krijonjëse, dhe nga një kuptim i drejtë i kërkesave të lexonjësve dhe t'artdashësve. Pak vjet më përpara, kur letërsija dhe artet tona të reja ishin akoma në fillimet e tyre timide, kur në letërsi mund të bëhej fjalë vetëm për vjersha dhe tregime të shkurtëra, kur në muzikë mund të gjenim vetëm disa këngë masash dhe në pikturë e skulpturë disa vepra, pak vjet më parë nuk ish e mundur që të krijoheshin kushtet që po krijohen sot për ne. Veçanërisht gjatë planit të parë pesëvjeçar, kur krijimtarija artistike dhe letrare mori një zgjerim që s'e kish njohur asnjëherë në Shqipëri, kur filluan të trajtohen gjinitë e mëdha, kur nisën të krijohen mundësi më të mëdha të shtypit, të skenës dhe t'ekspozimit, kur u shtuan mundësitë e edukimit të talentëve dhe të zgjerimit të radhëve tona, veçanërisht gjatë kësaj kohe, letërsija dhe artet tona kanë dhënë shënja të mira të rritjes dhe të pjekurisë së tyre. Dhe ja tani, në fillim të planit të dytë pesëvjeçar, duke analizuar punën tonë dhe duke parë perspektivat që çilen, Partia dhe Qeveria po krijojnë për ne këto kushte të çmueshme.

A është nevoja të përmend këtu mungesën e çdo kujdesi në regjimet e feudo-borgjezëve dhe të fashistëve? T'ju kujtoj se si muziktarët e talentuar përfundonin mësonjës muzike dhe u pikonte zëmra gjak për skenën dhe mikrofonin? T'ju kujtoj se si piktorët e skulptorët përfundonin mësonjës vizatimi dhe u pikonte zëmra gjak për t'ekzpozuar e për të ngritur mbi pedestal punimet e tyre? T'ju kujtoj se si me shkrimet tona jetonte drejtori i ndonjë shtypëshkronje dhe pronari i ndonjë gazete apo reviste? Puna letrare dhe artistike, që është një pjesë e rëndësishme e punës për ngritjen e kulturës kombëtare, ahëre bëhej në luftë të ashpër me regjimin e prapambetjes e t'errësirës, dhe në luftë me mizerjen. Mund të kujtonim këtu shokët tanë që e mbyllën jetën në lulen e rinisë, pa kujdesin për të cilin ata kishin nevojë, të persekutuar, si poeti i ynë i çquar Migjeni. Si ai pat dhe të tjerë. Mund të kujtonim se, në se bëhej një punë e përciptë e zakonisht e prapshtë për vënien në dukje të traditave tona letrare, nuk bëhej asgjë për vënien në dukje të traditave tona muzikore apo të pikturës. Muzika jonë aq e pasur dhe aq e larme popullore, mbetej zakonisht një muzikë krahinore e nuk bëhej pronë e gjithë popullit. Askush nuk e njihte pikturën tonë qindravjeçare t'afreskistëve dhe ikonografëve të talentuar si Onufri. Puna e tyre fshihej pas t'ymit të temjanit dhe nën zhulin e dyllit të kishave të vogla ku ata patën fatin e vështirë të punojnë.

Gjith këto e shumë të tjera mund të përmenden në këtë mbledhje të sotme, ku ne po shohim edhe një herë kujdesin e Partisë dhe të Qeverisë për letërsinë dhe artet. Ky kujdes është një cfaqje e punës së madhe vlerësonjëse dhe ndërtonjëse të Partisë dhe të Qeverisë sonë për ngritjen e jetës së re socialiste, për begatimin e vëndit, për lulëzimin e kulturës kombëtare. Ne që kemi parë se si vajti arsimit në çdo fshat t'atdheut, se si letërsija u përhap në çdo kasolle, se si u ngritën shkollat

tona për inxhinerë e mjekë, agronomë e profesorë, se si u krijuan mundësitë për një punë të gjerë shkencore, se si u krijuan teatrot profesioniste, filarmonija, muzetë etj, ne i çmojmë me zemër t'entusiasur këto realizime të mëdha të pushtetit tonë të ri, të Partisë sonë. Dhe sa m'i madh gëzimi, kur mendon njeriu se ka vënë diçka dhe ai, një gur sado të vogël, në monumentin e madh të kulturës së re që po ndërton populli i ynë i talentuar.

Ne shokë jemi në vigjiljen e 15 vjetorit të Partisë sonë të dashur, në këtë 15 vjetor heroizmi dhe pune të lavdishme të komunistëve të Shqipërisë. Ata ishin vetëm 200 kur e filluan, dhe tani janë dyzet mijë. Ata s'kishin veçse një kobure të vjetër kur e filluan, po tani ndërtojnë një atdhe socialist. Po ata kishin kuptuar dhe ndërë energjinë, forcën, talentin e madh të popullit tonë, që kishte mundur t'u bëjë ballë gjith rrebesheve të shekujve, sado i vogël që ish. Ne jemi krenarë për Partinë tonë, krenarë për popullin që e lindi, krenarë për miqësinë e madhe, pa të cilën ato mrekulli nuk mund të bëheshin, për miqësinë që lidhëm me Bashkimin Sovjetik. Tamam në vigjiljen e 15 vjetorit të saj Partija krijon për ne kushte të çmueshme pune. E pakufishme është dhe mirënjohja dhe dashuria jonë për Partinë dhe pushtetin e popullit. Ajo mirënjohje dhe dashuri, është provuar në krijimet tona. Ajo do të provohet edhe në krijimet tona t'ardhëshme, të cilat, pa dyshim, do të jenë më të bollëshme dhe më të mira. Ligjit të madh të jetës sonë për të krijuar më shumë dhe më mirë, letërsija dhe artet do t'i përgjigjen denjësisht.

Po, shokë, ne duhet të krijojmë më shumë dhe më mirë. Ne mburremi me të drejtë për tirazhet e librave tona, për mundësitë e mëdha të shtypit, të skenës etj. Këto të gjitha u krijuan sepse jeta jonë e re, që zhvillohet me vrull, nuk mund të bëjë pa to, sepse roli edukonjës i artit dhe i letërsisë në regjimin socialist shumfishohet. Populli ynë nuk mund ta kuptojë më jetën pa romane të reja, pa teatro profesioniste, pa monumente në pjacat dhe lulishtet e tij. Regjimet e kaluara të klasave sundonjëse, jo vetëm që karakterizoheshin nga prapambetja e madhe e masave, po dhe nga niveli shumë i ulët kultural i vetë klasave në fuqi. Këto akoma nuk ishin shkëputur mirë nga kultura anadollake, kur filluan të bijen në pellgun e lerës së kulturës dekadente borgjeze. Zgjerimi i kulturës në masa, ja ç'e karakterizon përpjekjen kulturale që po bëhet në vendin tonë. Po ne, si shkrimtarë, si kompozitorë, si piktorë apo skulptorë, nuk u përgjigjemi akoma sa duhet kërkesave përditë e më të mëdha për vepra letrare dhe artistike. Kushtet që u krijuan për ne tani, pa dyshim, do të bëjnë që prodhimi i ynë letrar e artistik të shtohet. Detyra jonë është që ne t'i çfrytëzojmë mirë e drejt këto kushte, të mos humbim kohën, t'i përndajmë mirë forcat tona, të punojmë fort. Dhe ne nuk duhet të harrojmë sidomos, se jemi akoma një grusht njerëz. Kaq pak sa jemi, nuk mund t'u bëjmë ballë kërkesave që rriten. Kondita e parë për të shtuar prodhimin tonë letrar dhe artistik, është që të shtohen radhët tona me talente të reja. Një nga të metat më të rëndësishme t'organizatave tona të shkrimtarëve dhe t'artistëve, ka qënë puna e pamjaftueshme dhe e dobët me talentet e reja. Një nga detyrat tona më kryesore në t'ardhëshmen, është puna me talentet e reja, zbulimi dhe edukimi i tyre.

Po ajo që po rritet gjithashtu shpejt, nuk është vetëm kërkesa për sasi, po sidomos kërkesa për cilësi. Në se kohën e tanishme e karakterizon zgjerimi i kulturës në masa, atë është duke e karakterizuar ngaditë e më shumë ngritja e nivelit kultural të masave. Pushteti i popullit

nuk zhduku vetëm analfabetizmin, po krijoi një armatë njerzish të rinj me arsim të mesëm e të lartë, çoi librin dhe kinemanë në viset më të prapambetura dhe të veçuara t'atdheut, dhe këtë gjë po e bën tani e tutje me suksese dhe rezultate shumë më të mëdha e të shpejta. Ne qahemi disaherë, dhe me të drejtë, se nuk na shiten sa duhet librat, apo nuk na ekzekutohen sa duhet kompozimet. Qahemi edhe se na shtypen apo na ekzekutohen disaherë keq. Po prap një arsye kryesore me tregun, që këngët tona shpesh harrohen edhe pse radioja mërzhitet së përsërituri, arsyeja nga më kryesoret duhet kërkuar mëndoj unë, jo te niveli i ulët i publikut që «lexon pak dhe e ndjek pak skenën e radion», po te rritja e vazhdueshme e nivelit artistik të publikut, të cilin ne e kënaqim pak. E kështu mund të themi se më se një skulpturë e jona nuk i përgjigjet pjacës në të cilën e kanë vendosur: njerzit shkojnë indiferentë pranë saj. A nuk është kështu? Ne këtë pyetje ia bëjmë vehtes vetë. Dhe përgjigjen ia japim vehtes vetë: cilësija le për të dëshiruar; duhet kapërxyer në një cilësi më të lartë; duhet ecur në çapin e kohës.

Më duket se është me vënd të theksoj rëndësinë e madhe të lejeve krijonjëse dhe të fondit financiar që ato do t'i mbështesë. Lejet do të na japin mundësinë të njohim realitetin tonë të sotëm që zhvillohet shumë shpejt. Një nga vështirësitë që paraqit krijimi artistik në shoqërinë socialiste, është tam kjo: se artisti, shkrimtari, po nuk jetuan në mënyrë shumë intensive jetën e çdo çasti, s'kanë se si ta njohin e ta përrshkruajnë atë. Në të kaluarën, jeta zhvillohej aq ngadalë, sa artisti kishte mundësi ta vëzhgonte me nge të madhe. Ne të gjithë e kuptojmë se nuk mjaftojnë lejet krijonjëse për të njohur jetën, se jeta duhet jetuar kudo e kurdo. Po lejet krijonjëse do të jenë një mjet i mirë për të njohur disa aspekte të ndryshme të jetës së fshatit e të fabrikave tona. Nga ana tjetër, do t'ishte shumë me vend që përndarja e forcave tona të pakta të jetë më e mirë nga ç'është sot. Fjala vjen, në se nëpër qytetet e krahinave gjinden disa kompozitorë dhe piktorë, shumë pak shkrimtarë kemi në qarqe. Jeta në qarqe paraqit një interes të madh për shkrimtarin. Nuk mjafton të shkosh herë pas here poshtë. Duhet të jetosh poshtë një kohë të gjatë. Vajtja e vendosja e disa shkrimtarëve që sot banojnë në Tiranë, nëpër vise të tjera të Shqipërisë, pa dyshim, do të jetë një mjet për ta zhvilluar e pasuruar më tej e më shpejt letërsinë e re me tema të reja. Partija na e rekomandon këtë gjë dhe ne duhet t'i përgjigjemi.

Çështja e cilësisë në letërsi dhe n'art, kuptohet shpesh në mënyrë të njëanëshme, si një çështje forme, mjeshtërije vetëm. Po ne e dimë mirë se ajo është në radhë të parë edhe një çështje brendije. Që të përsëris një të vërtetë të vjetër, po them se sa m'e fortë është materia, aq m'e përsosur del edhe vepra, I tillë mermeri, i tillë busti, do të thoshin skulptorët. Sigurisht, po duke mos kuptuar me fjalën mermer atë që kuptonin teoricienët e artit për art, thjesht gurin, — po tamam idenë e madhe, pa harruar mvëshjen e saj. Krijimet tona artistike vuajnë nga një mjeshtëri e pamjaftueshme, që shpjegohet nga një përgatitje e pamjaftueshme, si dhe nga traditat tona kombëtare jo sa duhet të zhvilluara. Dhe ne duhet të bëjmë shumë për të fituar zanatin, — për të njohur artin poetik, kompozimin, etj. Pa një punë të tillë, arti nuk shkon përpara. Pa dyshim, kështu është. Po cili mund të bëhet mjeshtër i vërtetë, pa futur realitetin në veprën e tij? Dhe a nuk është fakt që dobësija themelore e artit dhe e letërsisë sonë të re është prania e pamjaftueshme e realitetit, dhe veçanërisht e realitetit tonë të ri

në të? Ne po ndërtojmë një letërsi dhe një art të realizmit socialist, d.m.th. një letërsi dhe një art t'epokës së socializmit. Si mund të ndërtohen kjo letërsi dhe ky art pa temat e kësaj epoke, d.m.th. pa jetën e kësaj epoke? Gjersa tema aktuale, — në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë të fjalës, — veçanërisht tema e fshatit të ri shqiptar dhe tema e industrializimit të vendit, nuk do të mbisundojnë në krijimet tona, ne do të jemi akoma pas në kryerjen e detyrës për ndërtimin e letërsisë dhe t'artit tonë socialist. Dhe duhet të pranojmë se jemi akoma pas, se duhet të bëjmë shumë. Këtë do ta bëjmë duke jetuar poshtë, duke njohur për s'afërmi jetën, me lejet krijonjëse, me vendosjen në krahina, me intensifikimin e punës sonë shoqërore.

Po le të theksojmë edhe një herë çështjen e fitimit të mjeshtërisë. Çështja e cilësisë n'art, është dhe një çështje mjeshtërije në radhë të parë, një problem forme. Forma dhe brendija nuk shpëputen prej njëra-tjetrës, po janë prap se prap dy gjëra. Sa lehtë na bije në sy një pikturë e parealizuar, ku peizazhisti nuk ka dhënë harmoninë e domosdoshme të ngjyrave dhe të vijave. Të gjithëve u bije menjëherë në sy pamundësia e tij për të paraqitë realitetin në pëlhurë. Një fotografi e mirë, në të tilla raste, na kënaq më shumë, sepse nuk shtrembëron asgjë, sepse ruan hijedritat, perspektivën etj. Ne duhet të bëjmë një punë të madhe për ngritjen tonë mjeshtërore. Të gjithë e marrim me mend se të krijosh një roman sot, duke u nisë nga proza e paraluftës, të krijosh operetën ose operën e parë nga hiçi, të bësh një kompozim të madh piktoral etj, janë probleme të mëdha, të cilat zakonisht i zgjidhin brezat dhe që zgjidhen pra kolektivisht. Kështu mund të themi se te «Lufta dhe Paqa» e Tolstojit, kanë kontribuar kaq e kaq prozatorë të mëparëshëm rusë. Dhe proza jonë akoma modeste e sotme nuk mund të kuptohet pa Mihal Gramenon, Foqion Postolin, Haki Stërmillin e të tjerë. Po teksa në të kaluarën, ndihma letrare bëhej në mënyrë zakonisht spontane, sot ne kemi mundësi që atë ta organizojmë mirë e më mirë, dhe ky nuk është një avantazh i vogël për ta çuar letërsinë dhe artin përpara.

Ne po ngremë një kolektiv të ri. Me këtë rast, duhet të pranojmë se në punën tonë të gjertanishme, si Lidhje e Shkrimtarëve dhe si Lidhje e Artistëve, ka munguar me të madhët puna e organizuar, d.m.th. ndihma e organizuar. Ka pasë arsye objektive për këtë, sidomos në Lidhjen e Artistëve. Po ka pasë edhe neglijime të vazhdueshme, për shembull në Lidhjen e Shkrimtarëve. Nuk është rasti që ne të merremi sot me analizën e dobësive tona. Po nuk mund të mos kujtojmë se, sikur organizatat tona të kishin punuar mirë, përparimi i letërsisë dhe i arteve do të kishte qënë edhe m'i madh. M'e madhe do të kishte qënë përgatitja jonë ideologjike e profesionale, më të mira dhe më të bollëshme krijimet tona.

Në vendimet e tyre, Partia dhe Qeveria na rekomandojnë që të krijojmë një organizatë të përbashkët të shkrimtarëve dhe artistëve. Ish-komitetet tona drejtonjëse, në mbledhjen e tyre të fundit, e pranuan me gëzim këtë rekomandim. Krijimi i kësaj organizate është, pa dyshim, dëshira e përbashkët e shkrimtarëve dhe artistëve. Dhe detyra kryesore e kësaj mbledhje të përgjithëshme të shkrimtarëve dhe artistëve është që të krijojnë organizatën e tyre të përbashkët. Sigurisht, organizimi i shkrimtarëve dhe artistëve në një shoqëri të vetme ka të mirat dhe vështirësitë e tij. Ne jemi një pakicë njerzish dhe ndarja jonë më dysh, bën që të kemi dy organizata të vogla, të cilat nuk e justifikojnë plotë-

sisht qënien e tyre. Nga ana tjetër, probleme të përbashkëta themelore i preokupojnë artet e ndryshme dhe letërsinë, probleme që kërkojnë të rrihen e të zgjidhen bashkarisht nga artistët dhe shkrimtarët, të mbikqyren nga një udhëheqje unike. Po vështirësitë e organizimit dhe të drejtimit duhet t'i kemi parasysh. Ne duhet të kërkojmë format më të mira t'organizimit, në mënyrë që të mos na preokupojë vetëm çka na bashkon, po dhe specifika vetë e letërsisë dhe e secilit art, gjë që është gjithashtu themelore.

Komisioni që zgjodhën të dy komitetet tona drejtonjëse për të përgatitur këtë mbledhje, ka menduar që t'i propozojë kësaj mbledhje një komitet drejtonjës provizor, i cili t'udhëheqë organizatën tonë të re gjer sa të mblidhet, aty nga tremujori i parë i vitit 1957, kongresi i organizatës sonë. Komitetit drejtonjës provizor do t'i bjerë barra që të studiojë e të gjejë format më të mira t'organizimit të punës sonë, në mënyrë që Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të bëhet një levë e fortë për t'i shpënë përpara letërsinë dhe artet. Kushtet që krijuan Partija dhe Qeverija për punën tonë krijonjëse, do të ndihmojnë funksionimin e mirë t'organizatës sonë të re.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve duhet të bëhet një shoqëri e gjallë e luftarake, ku të rrihen e të zgjidhen problemet që i dalin përpara artit dhe letërsisë së realizmit socialist në Shqipëri. Përmes diskutimeve krijonjëse, përmes botimeve, kritikës letrare dhe artistike, shtrimit të problemeve tona teorike, ndihmës, shoqërore që do t'i japim njeri-tjetrit në përpunimin e veprave, zbulimit dhe ndihmës talenteve të reja, luftës kundër çfaqjeve të huaja për artin dhe letërsinë tonë, organizata jonë e re mund dhe duhet të bëhet mjete m'i fuqishëm për mbarëvajtjen e artit dhe të letërsisë shqiptare, të kulturës sonë socialiste në përgjithësi.

Fakti se në letërsinë dhe n'artet tona të kaluara, pak e aspak morën jetë tendencat e dekadentizmit të letërsive dhe arteve të borgjezisë, na bën shpesh që ne të harrojmë rrezikun e lindjes së tentativave dhe tendencave të huaja për realizmin socialist në letërsinë dhe n'artin tonë. Po të mendosh kështu, është gabim. Sadopak, tendencat dekadente ekzistuan në letërsinë tonë të paraluftës. Ato nuk mund të thomi se ishin krejt të huaja për artet tona figurative. Disa prej nesh që kanë një jetë të gjatë në fushën e krijimtarisë, nuk kanë qënë pa influencime ose pa simpatira ndaj simbolizmit, impresionizmit, ndaj futurizmit në trajtat e ndryshme të tij. Nga ana tjetër, gjersa në shoqërinë shqiptare ekzistojnë klasat, do t'ekzistojnë edhe mbeturinat e kulturës së klasave që dje ishin në fuqi. Kjo kulturë, tani në zhdukje e sipër, bën rezistencën e saj, si vetë klasa që e mbart. Dhe lufta kundër asaj kulture, është një pamje e luftës së klasave që ekziston në vendin tonë. Format që mvesh rezistenca e kulturës s'armikut, mund të jenë nga më të ndryshmet. Orvajtja që bënë pak vjet më parë një numur sado shumë i kufizuar shkrimtarësh kundër realizmit socialist, duke u nisë gjoja nga dëshira për një liri më të madhe ose të plotë krijonjëse, për të trajtuar t'ashtuquajturat tema të përjetëshme, d.m.th. për t'u shkëputë nga aktualiteti, nga lufta për socializmin, për ta parë gjithashtu të kaluarën, jo me syun e ndërtonjësit të socializmit, po me nostalgjinë e klasave të përmbysura, për të mohuar partisinë komuniste n'art, për t'u tërheqë në kullën e fildishtë të një pseudoromantizmi, që, anakronikisht, përpiqej të dalë nga briri i Bajronit, kjo përpjekje për nënvleftësimin ose mohimin e metodës sonë artistike, përbuzja e gjithçkaje që ne kemi

krijuar në rrugën e realizmit socialist, gjith këto kushte paraqitnin një rrezik të vërtetë për letërsinë dhe artet tona. Po a thua se këto tendenca lindën kot? A nuk ishin këto tendenca, ku të ndërgegjëshme dhe ku të pandërgjegjëshme, për ta shkëputë letërsinë tonë nga rruga e saj e drejtë, për denigrimin e metodës sonë artistike? Pse ngjau kjo kështu? Kjo ngjau për arsye e thjeshtë se mbeturinat e kulturës antipopullore nuk janë zhdukë në vendin tonë, se presioni i vazhdueshëm i kulturës borgjeze është një realitet dhe një rrezik që ekziston. Arti ynë i ri do të rritet pa tjetër në luftë me artin e vjetër, në luftë me mbeturinat borgjeze në ndërgegjet jo vetëm të masave, po në radhë të parë të shkrimtarëve dhe t'artistëve vetë. Këtë luftë, ai nuk do ta bëjë vetëm kundër artit të sotëm të botës së jashtme borgjeze, po veçanërisht kundër bishlave që arti borgjez mund të lëshojë tek ne. Ne duhet të jemi të ndërgegjëshëm dhe vigjilentë për një luftë të tillë, dhe nuk duhet të harrojmë se përgatitja jonë e pamjaftueshme ideologjike nuk është n'avantazhin tonë. Përpjekja jonë për t'u armatosë ideologjikisht duhet të jetë pra e madhe.

Lufta që ne bëjmë kundër manifestimeve t'artit borgjez në vendin tonë, nuk është lufta kundër lirisë për të krijuar, po tamam lufta për më shumë liri krijonjëse, pastrimi i terrenit t'artit nga drizat që mund ta pengojnë. Zhvillimi i gjithanëshëm e i shpejtë i letërsisë dhe arteve në Bashkimin Sovjetik, dhe pas luftës së dytë botërore në vendet e demokracisë popullore, pa harruar zhvillimin që kanë filluar të marrin në vetë botën kapitaliste arti dhe letërsija që e kanë lidhur fatin e tyre me luftën e proletariatit, gjith këto provojnë në mënyrë të shkëlqyer vitalitetin e madh të realizmit socialist, mundësitë e pakufishme të zhvillimit të tij, lirinë e vërtetë të krijimit, larminë e stileve, mundësinë e lulëzimit të çdo personaliteti pozitiv aristik. Në botën borgjeze flitet për «krizë» n'artet dhe në letërsinë tonë të realizmit socialist. Kjo ngjet sa herë që ne vështrojmë me syun kritik e të mprehtë të ndërtonjësve të socializmit krijimtarinë tonë. Kështu ngjet edhe sa herë ne luftojmë sheshazi, — dhe ne luftojmë vetëm sheshazi, — dobësitë tona në çdo lëmë të veprimtarisë ekonomike, shoqërore e kulture. Po planet tona pesëvjeçare krijojnë vlera materiale e morale për të cilat u desh disa shekuj që të krijohej nga shoqëria kapitaliste. Kapitalistët i qajnë hallin kalorësit se i mvaren në këmbët. Po kjo ne nuk duhet të na bëjë vetëm të qeshim me ta. Kryesorja është që ne t'afirmojmë nga dita e më shumë, me punën tonë krijonjëse, fuqinë e artit dhe të metodës sonë të realizmit socialist, që është një çfaqje e fuqisë së shoqërisë sonë të re socialiste. Dhe kjo fuqi duhet të mposhtë çdo tentativë të papajtueshme me përpjekjen tonë artistike.

Të gjithë e kuptojmë se sa rëndësi të madhe ka për këtë luftë dhe për punën tonë krijonjëse njohja e eksperiencës së madhe sovjetike në fushën e ndërtimit të letërsisë dhe t'artit socialist. Njohja e kësaj eksperience ka qënë për ne, ashtu si ç'ka thënë shoku Enver Hoxha, një shkollë e madhe e një burim frymëzimi. Dhe kështu ka për të qënë. Njohja e kësaj eksperience, nuk lejon imitim formal e shabllonizmin. Ne krijojmë artin dhe letërsinë tonë kombëtare të realizmit socialist. Njohja dhe çfrytëzimi i traditave tona kombëtare janë të domosdoshme. Dhe prap për këtë çështje, letërsija shumëkombëshe sovjetike mund të na japë një mësim shumë të çmueshëm.

Të dashur shokë. Organizata jonë e re ka detyra të rënda dhe të rëndësishme. Unë jam i sigurtë se shpreh mendimin tuaj, duke thënë se,

këndeje e tutje, fuqitë tona të bashkuara të shkrimtarëve dhe artistëve do të bëjnë hapa të mira e të shpejta përpara në rrugën e ndërtimit të kulturës sonë të re. Unë jam i sigurtë se shpreh ndjenjat tuaja më të flakta duke falenderuar Partinë tonë të Punës dhe Qeverinë e Republikës për kujdesin e vazhdueshëm që kanë treguar për letërsinë dhe artet tona të reja. Premtimi m'i madh që ne mund t'i bëjmë popullit në këtë vigjilje të 15 vjetorit të Partisë sonë të dashur, është që të pohojmë dhe një herë vullnetin tonë për të prodhuar më shumë e më mirë, për të krijuar gjithashtu një organizatë luftarake dhe të fortë për çështjen e letërsisë dhe t'arteve në Republikën tonë popullore.

Rroftë Partia jonë e Punës dhe Komiteti i saj Qëndror leninist!
Rroftë Qeverija e Republikës Popullore të Shqipërisë!

Pas fjalës së shokut Dhimitër Shuteriqi, që u ndoq me vëmendje të madhe nga të pranishmit, filluan diskutimet.

«Më vjen shumë mirë të pohoj, — tha ndër të tjera në diskutimin e tij shkrimtari Sterjo Spasse —, se ky vendim është një nga sihariqet më të bukura që u është dhënë punonjësve të letërsisë dhe arteve nga ana e Partisë dhe e Qeverisë sonë. Dhe gëzimi ynë është i dyfishtë: jo vetëm se po na krijohen kondita kaq të mira për të punuar, porse këto kondita na tregojnë se sa fort e çmojnë Partia dhe Qeveria jonë misionin e letërsisë dhe t'arteve në ndërtimin e socializmit. Ky vlerësim na jep krahe në punën tonë... Detyra jonë kryesore është të dimë t'i çtrytëzojmë këto drejt. Ne duhet të krijojmë traditat e punës së përditëshme, të bëjmë çmos për të kuptuar madhësitë e epokës sonë, që te jemi pastaj në gjëndje ta pasqyrojmë në krijimet tona. Prandaj duhet të përpiqemi seriozisht ta njohim realitetin e jetës së re shqiptare me gëzimet, me të mirat dhe me vështirësitë e saj.»

Duke diskutuar rreth vendimit të sekretariatit të K.Q. të Partisë dhe Këshillit të ministrave, shoku Albert Paparisto, muzikolog, theksoi përparimet që janë bërë në vendin tonë në fushën e letërsisë e të arteve.

«Nuk ka dyshim — theksoi ay — se në fushën e arteve duke marrë parasysh kohën relativisht të shkurtër, janë arrijtë rezultate të rëndësishme. Po të flasim për muzikën, na mund të konstatojmë me kënaqësi, se në vendin tonë për të parën herë është krijuar një jetë muzikore, aua të them që na sot kemi operën, orkestrën simfonike, baletin, një lëvizje të madhe diletante, shpesh me një nivel artistik të ngritur, që janë një bazë e shëndoshë e zhvillimit të muzikës sonë dhe një stimul i fuqishëm për krijimtarinë artistike të kompozitorëve. Na e dimë se një shumicë kompozitorësh lindën pikërisht nga kjo lëvizje dhe veprimtaria e tyre krijonjëse është lidhur ngushtë me këtë lëvizje.

Por jeta e jonë zhvillohet me shpejtësi të madhe. Është rritur niveli kultural i masave, është rritur dhe kërkesa e tyre për veprat artistike.

Vendimi i Komitetit Qëndror dhe Qeverisë është një masë e rëndësishme që do të ndihmojë efektivisht artistët tanë. t'u përgjigjen këtyre kërkesave, të shtojnë aktivitetin e tyre krijonjës dhe të ngrenë cilësinë e veprave.

Sot një radhë problemesh ka vënë jeta përpara muzikantëve tanë. Për këto është e nevojshme të organizohen diskutime me një pjesmarrje të gjerë të anëtarëve të Lidhjes, të rrihen mendimet, në mënyrë që të ndihmohet puna krijonjëse.

Një problem i tillë janë p.sh. këngët për masat.

Po t'i hedhim një sy prodhimit muzikor në vendin tonë, qoftë dhe për vitin e fundit, do të konstatojmë se një vend të math zënë këngët për masat. Kjo gjini qëndron në qëndër të krijimtarisë sonë. Një gjë e tillë kondicionohet nga shumë faktorë, midis të tjerash dhe nga një kërkesë e madhe e popullit për to. Këngët e masave më shumë se çdo gjini tjetër dhe në mënyrën më konkrete lidhen me jetën aktuale, i përgjigjen nevojave të përditëshme të masave për të shprehur ndjenjat e tyre; janë gjinija që kuptohet, përvetësohet më lehtë dhe që ekzekutohet prej vetë masave. Prandaj vetë orientimi i kompozitorëve drejt këtyre këngëve është një gjë pozitive për muzikën tonë, sepse thekson karakterin e saj demokratik.

Në prodhimet e këngëve për masat ka një tematikë pak a shumë të gjerë. Një pjesë e mirë prej tyre janë të lidhura drejt për drejt me transformimet politike e ekonomike të vendit; kurse pjesa tjetër prek një sferë më të përgjithëshme të jetës shoqërore, sidomos atë lirike. Kështu këngët kanë lojtr dhe lozin një rol me rëndësi në edukimin e masave, në formimin e ndërgjegjes socialiste të tyre.

Shumë suksese janë arrijtë në këtë drejtim. Mjaft këngë janë bërë pronë e punonjësve.

Megjithatë, muzika e jonë është një muzikë e re, përpara kompozitorëve tanë ka akoma shumë rrugë të pashfrytëzuara për zhvillimin e saj, ka akoma shumë për të bërë. Ne duhet të ecim krahas kërkesave artistike të masave që rriten çdo ditë, duhet të mos mbetemi në vënd; prandaj duhet të dëgjojmë me kujdes edhe zërin kritik të punonjësve n'adresën tonë. Thuhet p.sh. se shumë këngë janë të ngjajshme njera me tjetrën. Një vërejtje e tillë, që me të drejtë bëhet prej shumë njerëzve, nuk ka si të mos tërheqë vëmendjen tonë. Këtu është fiala për ekzistencën e një rrethi të ngushtë intonacionesh që vërtiten në një shumicë këngësh, për mungesë individualiteti në to.»

Po kështu, shkrimtari Shevqet Musaraj duke folur për gëzimin që ndiejnë shkrimtarët dhe artistët në krijimin e kushteve të reja për punën krijuese tha ndër të tjera: «Them konditat e reja seose, sikundër dihet që nga klimi e këtej Partia dhe Qeveria jonë janë kujdesur vazhdimisht dhe kanë krijuar herë pas here kondita më të mira për punën tonë krijonjëse. Vetë krijimi i Lidhjes së Shkrimtarëve që më 1945 dhe i Lidhjes së Artistëve më vonë, subvencionet shtetërore për mbajtjen dhe zhvillimin e tyre, ligia mbi të drejtat e autorit, vendimet e majit 1949, ligia mbi çmimet e Republikës për veprat më të mira të letërsisë e të artit, konkurset nacionale e të tjera, kanë qënë gjë e madhe për një shtet të ri, si shteti ynë, për një vënd si tonin që trashëgonte nga e kaluara një varfëri të madhe ekonomike.»

Më tutje ay theksoi:

«S'ka dyshim se konditat e reja që vendosi për ne Këshilli i Ministrave, hapën perspektiva të mëdha për letërsinë dhe artet. Por, nga eksperiencia e afro 10 vjetve në udhëheqjen e Lidhjes së Shkrimtarëve, unë mendoj se, pa një organizim të fortë dhe pa një udhëheqje operative të shëndoshë, do jetë shumë vështirë, nëmos e pamundur, që ne t'u dalim ndëruar në krye detyrave dhe përgjegjësive që na vihen përpara në këtë situatë të re.

Vetëm një drejtim operativ dhe një organizim i fortë do të mund të vërë në rrugë çështjen e diskutimeve tona krijonjëse dhe të kritikës le-

trare e artistike, çështje që përbëjnë, sipas mendimit tim, shkallën kryesore të ngritjes sonë ideologjike dhe profesionale.

Me një drejtim dhe organizim të tillë do të mund të zbatohen planet për zbritjen e shkrimtarëve dhe artistëve poshtë, për të jetuar me masat punonjëse, për të njohur atë realitet të madh të kohës sonë, pa të cilin s'mund të kemi vepra të realizmit socialist në kuptimin e thellë të fjalës.

Esencjale është çështja e drejtimit operativ dhe organizimit të fortë edhe për edukimin e talenteve të reja letrare e artistike, edhe për trajtimin e temave dhe gjinive që janë më të nevojshme, edhe për bashkëpunimin tonë në shtypin e përditshëm — probleme këto që janë ngritur vazhdimisht me forcë dhe që, me gjithë këtë, nuk kanë gjetur dot rrujë zgjidhjeje.»

«Vendimet që dëgjuam sot këtu tha në diskutimin e tij shkrimtari Fatmir Gjata — janë një provë tjetër, një dëshmi e madhe e kujdesit të Partisë për letërsinë dhe artin. Këto masa të reja të Partisë do të na nxitin për një punë akoma më të vrullëshme.»

Pastaj duke theksuar rolin që duhet të lozë Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve në të ardhmen ay tha: «Në edukimin tonë profesional, në njohjen e realitetit, rol të madh duhet të lzë organizata jonë. Ne e kemi ndjerë vehten larg Lidhjes sepse nuk kemi patur ndihmën e duhur prej saj. Kjo mënyrë pune ka sjellë dëmet e saj, ja përse ne duhet t'a mënjanojmë këtë të metë dhe të mos harrojmë se pa një bashkëpunim të fortë, pa një drejtim kolegjal nuk mund të zgjidhen çështjet e vështira dhe të rëndësishme të letërsisë e të artit. Prandaj duhet t'a forcojmë organizatën tonë, të aktivizojmë komisjonet e saj, t'i gjallërojmë dhe kjo do t'a shtyjë punën tonë para.

Në diskutimin e tij piktori Foto Stamo vuri në dukje se:

«Letërsia dhe arti në vendin t'onë janë zhvilluar, ato kanë ecur përpara dhe kanë shërbyer kështu në ngritjen kulture dhe ideologjike të masave punonjëse të vendit t'onë. Veprat e artit dhe të letërsisë sonë të re sado të pakta në numur ato kanë milituar për mësimet dhe vijën e Partisë sonë, ato kanë inspiruar masat punonjëse për një jetë të re dhe më të begatëshme, më të lumtur dhe paqësore. Në këtë drejtim punonjësit e artit dhe vepra e tyre ka kryer një shërbim të çmueshëm në dobi të popullit, kanë kryer kështu porosinë e partisë. Për këtë punonjësit e artit dhe të letërsisë janë krenarë se vepra e tyre i shërben një qëllimi të shenjtë, i shërben përparimit të vendit, i shërben popullit. Prandaj ata do t'i përgjigjen këtij kujdesi që tregon Partija dhe Qeverija jonë me vepra të reja të një cilësie me të lartë artistike dhe të një përmbajtje të shëndoshë.

Çkrija e Lidhjeve të Shkrimtarëve dhe t'Artistëve në një organizatë të përbashkët të Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë me siguri do të favorizojë për një punë më të frutëshme krijonjëse, do të bashkojë forcat drejtonjëse në një drejtim unik për letërsinë dhe artin, do të krijojë një bashkëpunim më të ngushtë midis shkrimtarëve dhe artistëve për krijimtarinë e tyre për të cilën ne kemi patur mjaft dobësi në punën tonë dhe që e kemi kritikuar shpesh herë, do të krijojmë kështu një fushë më të gjerë të bashkëpunimit dhe të diskutimeve krijonjëse. Pikërisht për këtë unë jam plotësisht dakord me bashkimin e dy organizatave tona krijonjëse të letërsisë dhe të arteve në një organizatë të përbashkët të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Ne shokë duhet t'i përgjigjemi me punë të pa lodhur dhe me një krijimtari të pasur këtyre konditave dhe privilegjeve që na krijohen neve sot nga Partija dhe Qeverija jonë. Ne duhet të kryejmë me nder detyrat tona në fushën e letërsisë dhe t'arteve, të rritim më shumë aftësitë t'ona krijonjëse duke u përfeksionuar më shumë në profesionin t'onë, të rritim cilësinë artistike të veprave, të rritim kualitetin e tyre, të forcojmë përmbajtjen e veprave t'ona duke krijuar episode dhe tema interesante që të trajtojnë probleme me rëndësi, nga historia e popullit t'onë, vepra t'atilla që të gëzojnë një popullaritet në masat punonjëse. Të krijojmë vepra të gjalla të bukura dhe heroike që të ngjallin në masat e popullit ndjenjën e së resë, ndjenjën e s'arthmes, heroizmin, dashurinë për jetën, për Partinë dhe për popullin t'onë; ne sot i kemi të gjitha mundësitë për një t'arthme më të ndritur dhe me pozitive të letërsisë dhe t'arteve në vendin t'onë».

Gjithashtu poeti Llazar Siliqi, duke marrë fjalën preku një sërë çështjesh që lidhen ngushtë me përmirësimin e cilësisë dhe zgjerimin e problemeve që duhet të trajtojë revista «Nëndori» si organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve.

Diskutuan gjithashtu shokët Ibrahim Uruçi, Mustafa Krantja, Zisa Cikuli, Selman Vaqari, Hasan Reçi etj.

Mbledhja vendosi njëzëri shpërndarjen e organizatave «Lidhja e shkrimtarëve të Shqipërisë» dhe «Lidhja e artistëve të Shqipërisë» dhe krijimin e organizatës «Lidhja e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë». Po kështu mbledhja zgjodhi komitetin drejtonjës provizor të organizatës, i përbërë prej 17 vetësh: Dhimitër Shuteriqi, Fatmir Gjata, Kolë Jakova, Llazar Siliqi, Spiro Çomora, Sterjo Spasse, Zihni Sako, Albert Paparisto, Baki Kongoli, Çesk Zadeja, Kristo Kono, Prenkë Jakova, Andon Kuqali, Andrea Mana, Foto Stamo, Nexhmedin Zajmi, Odhise Paskali.

Nga ana e tij komiteti provizor zgjodhi kryesinë e përbërë nga Dhimitër Shuteriqi kryetar, Albert Paparisto, Foto Stamo dhe Llazar Siliqi sekretarë.

Në fund e mori fjalën Shqija Liri Belishova. Ajo pasi foli mbi rëndësinë e vendimit të Sekretariatit të Komitetit qëndror të Partisë dhe Këshillit ministrave tha ndër të tjera: «Ky vendim krijon vetëm mundësitë. Varet nga ju që këto mundësi t'i ktheni në realitet. Unë mendoj se shkrimtari ose artisti, me parti ose pa parti, e ndjen thellë e në mënyrë të veçantë, përgjegjësinë para Partisë dhe pushtetit popullor, sepse populli ynë pret nga ju shumë, që me të vërtetë quheni inxhinjerë të shpirtit të njeriut. Nga veprat tuaja populli duhet të frymëzohet, të edukohet dhe të hedhë poshtë çdo gjë që e pengon të ecë përpara... Në Shqipërinë e re janë arritur mjaft rezultate në fushën e letërsisë e të arteve. Po kemi shumë për të bërë».

Ajo vuri në dukje gjithashtu një sërë problemesh që dalin para shkrimtarëve dhe artistëve dhe pasi theksoi nevojën e një bashkëpunimi të ngushtë të të gjitha forcave krijuese për mbarëvajtjen e letërsisë dhe arteve, uroi pjesëmarësit në mbledhje për suksese të reja e të mëdha.

Nga mbledhja iu dërgua ky telegram Komitetit Qëndror të P.P. Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës popullore të Shqipërisë.

KOMITETIT QENDROR TE P.P.SH., KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPERISE

Shkrimtarët dhe artistët, të mbledhur për të punuar vendimet e Sekretariatit të Komitetit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë mbi riorganizimin e lidhjeve të Shkrimtarëve dhe t'Artistëve dhe mbi krijimin e konditave të reja më të mira për punën kriuese, falënderojnë nga zemra Partinë e Punës dhe Qeverinë e Republikës, për kujdesin e madh e të vazhdueshëm që ato kanë treguar për letërsinë dhe artet, e veçanërisht për vendimet që ato kanë marrë tani për riorganizimin tonë dhe për të na krijuar kondita të reja më të mira për punën tonë krijuese. Ne u premtojmë Partisë dhe Qeverisë se do të vemë gjith forcat tona për t'i shpënë me hov përpara letërsinë dhe artet tona të realizmit socialist, se do të vemë gjith forcat tona për të prodhuar më shumë e më mirë, se do të jemi në ballë të përpjekjeve të popullit tonë heroik e kaq të talentuar, për zhvillimin e kulturës sonë socialiste. Jeta dhe aspiratat e popullit tonë do të jenë për ne burimi i madh i frymëzimit. Ne do të vemë në jetë porositë e Partisë sonë të dashur për një letërsi dhe një art të realizmit socialist të denjë t'epokës sonë të lavdishme, duke u mbështetur vazhdimisht te eksperiencia e madhe e letërsisë dhe e arteve sovjetike, duke përfituar nga traditat e mëdha të letërsisë e t'arteve botërore, duke u mbështetur përditë e më mirë në traditat e letërsisë dhe t'arteve tona kombëtare.

Rrofshin Partija jonë e Punës së Shqipërisë dhe Qeverija e Republikës Popullore të Shqipërisë!

Nga mbledhja plenare e shkrimtarëve dhe artistëve

BAJRAM HYSËNI

Partisë

Për ty Parti dua një këngë të ngrej
t'fuqishme, që edhe qiejt ta dëgjojnë,
e në qoft se ka sokola dhe ndër qiej
më t'mirën këngë për ty do ta këndojnë...

Sa hymne e vargje thurën për partinë
miliona t'lrë (a ka më t'madh poet?)
vet fjal' e saj këngë është për njerinë,
që në dheun tonë këndohet tash sa vjet.

Me mijra vjet ne armët nuk i lëshuem
në zjarr u rreshkëm, s'tregohen dot mundimet,
me ty parti, drejt brigjesh të reja vluem
me hov shqiponjash nisëm fluturimet.

Zërin tënd dëgjuam n'ditë të vështira
Parti: n'fusha, male zbardh prej bore,
nga nënat tona, zemërat e dlira,
në valë të kryengritjes popullore

Si zogj shqiponje na mblodhe me mijra
si yll polar na ndrit e na drejton
n'shtigje të mëdha e për vepra të mira
çdo fjalë e jote çelnik na bashkon.

Do ikin ditët, do ikin muaj, vjete...
jeta jonë më mirë ka me u përtëritë.
Do të rrjedhin ujra, e do t'thahen dete
veç ylli tënd më shumë ka për të ndritë...

Buzë Adriatikut

Mbi shkëmbin q'e rreh vala jam ul e po mendohem
e sodis bregdetin, dallgët ledhatare.
Vështroj e fërkoj sytë: A mundet të gabohej?
E bukur kaq t'iesh o toka shqipëtare?

Sikur mijra fjal t'gjej, sa valat palë-palë
që kputen e përplasen bregut me puhi,
të thursha për ty det ma t'bukrën poezi!
Por! Bukuria jote nuk thuret kurr me fjalë

Ekspozita e arteve figurative sovjetike në Shqipëri

idetë komuniste, të rrënjosura në zemrën e shkrimtarit, kanë marrë vullën e personalitetit të tij dhe janë bërë për të më tepër se një e vërtetë objektive, janë bërë bindja e tij, ndërgjegjia e tij, botëkuptimi i tij: ajo supozon që shkrimtari, në vënd që të zbavitet duke zbukuruar të parën ide që ka dëgjuar diku ose që ka lexuar nëpër gazeta, të krijojë me pasion, duke u kredhur në mendime e në kërkime shpesh të mundimshme, po pa të cilat nuk mund të bëhet kurrë një vepër arti prekëse.

Fryma e partisë në letërsi është e pandarë nga fryma e kombit. Në shoqërinë sovjetike zhvillimi i letrave është një element i veprës së mbarrë kombit, i gjithë Shtetit, i socializmit. Pikërisht kjo u jep atyre frymën e tyre të partisë. Socializmi shkencor u ka dhënë shkrimtarëve të B.R.S.S. një mënyrë të shikuarit të botës që u lejon ta pasqyrojnë jetën në thellësi dhe pa kompromis. Dhe ne gëzohemi kur shohim se shkrimtarët e vëndeve të demokracisë popullore, me përjashtime shumë të rralla, janë të një mendjeje me ne. Duke nxjerrë mësimet e kongresit të dytë të shkrimtarëve çekoslovakë, shtypi çek ve në dukje se diskutimi, në tërësi, përshtoket nga një ide e drejtë: e vërteta për të cilën duhet të lëftojë letërsia pararojë është e vërteta e socializmit; interesat e popullit që duhet të shprehë e të mbrojë letërsia, identifikohen me interesat e klasës punëtore; e vërteta letrare nuk është dhe as nuk mund të jetë në kundërshtim me frymën e partisë në letërsi, me ideologjinë komuniste.

Disa oratorë të huaj kanë kërkuar që letrat të përjashtoheshin nga ndërhyrja e Partisë. Për këtë qëllim, ata i janë referuar Leninit, po duke e shtrembëruar krejt botëkuptimin e tij të ndërhyrjes në zhvillimin e artit në shoqërinë socialiste.

Lenini është ruajtur gjithëmonë t'i imponojë artit shijet e tij personale dhe nuk i ka paraqitur kurrë opinionet e tij në këtë fushë si të vërteta të pamohueshme. . . «Vladimir Iliç nuk i ka ngritur kurrë në direktiva simpatitë ose antipatitë e tij estetike», shkruante Lunaçarski. Lenini ishte kundër çdo autoritarizmi në art.

Lenini, megjithatë, ishte i mendimit se Partia duhet me domosdo të udhëheqë letrat dhe artet. Ai dënonte me forcë pretendimin e çdo grupi letrar për pavarësi ndaj Partisë dhe Shtetit. Në bisedën e tij me Klara Zetkinin mund të lexojmë: «Çdo artist, kushdo që e quan veten të tillë, ka të drejtë të krijojë në liri të plotë, në përputhje me idealin e tij, në pavarësi të plotë. Por, kuptohet, ne jemi komunistë. Nuk duhet të lidhim duart dhe ta lëmë kaosin të shtrihet sipas qejfit. Ne duhet ta udhëheqim këtë proces sipas një plani të hartuar dhe të gatim rezultatet e tij».

Kjo është në përgjithësi zgjidhja që i ka dhënë Lenini problemit të zhvillimit të letrave dhe të arteve në një Shtet socialist. Ajo s'ka humbur asgjë nga aktualiteti i saj.

Një ngjarje me rëndësi shumë të madhe për jetën artistike të vëndit tonë është hapja e ekspozitës së arteve figurative sovjetike. Kjo është e para herë që në vëndin tonë hapet një ekspozitë e huaj e arteve figurative, me vepra origjinale. Përveç asaj ekspozita ka rëndësi edhe më të madhe sepse ajo është e artit sovjetik, art për të cilin në vëndin tonë tregohet një vëmendje e posaçme.

Ekspozita po vizitohet vazhdimisht nga një numur i madh spektatorësh që me shumë gëzim dhe kënaqësi po njihen drejt për drejt me veprat e artit sovjetik. Në sallat e saja zhvillohen diskutime të gjalla.

Drejtonjësi dhe organizatori i kësaj ekspozite në Shqipëri, shoku J. Miller, ka mbajtur përpara artistëve dhe njerëzve të kulturës disa biseda mbi problemet e artit sovjetik, mbi problemet e natyrës së qetë, peizazhit dhe portretit sovjetik. Këtu janë bërë pyetje të ndryshme dhe janë shprehur mendime dhe opinione mbi veprat e paraqitura.

Shoku J. Miller, që është bashkëpunëtor i Muzeut të Ermitazhit në Leningrad ka patur mirësinë të shkruajë për ne disa rradhë mbi këtë ekspozitë, që po i botojmë këtu poshtë.

Red.

Më 18 tetor të këtij viti në selinë e Shoqërisë së Miqësisë «Shqipëri — B.R.S.S.» në Tiranë u hap ekspozita e arteve figurative sovjetike. Më përpara kjo ekspozitë ishte në kryeqytetin e Republikës Popullore të Bullgarisë, Sofje dhe në kryeqytetin e Republikës Popullore të Rumanisë, Bukuresht.

Detyra kryesore e kësaj ekspozite është që t'i bëjë të njohur rrethet e gjëra të publikut, punonjësit e artit, me artet figurative sovjetike. Në përputhje me këtë detyrë në përbër-

jen e ekspozitës janë futur vepra të ndryshme si të piktorëve të njohur ashtu edhe të piktorëve më të rinj, të skulptorëve dhe të grafistëve. Shumica e këtyre veprave u përkasin viteve të fundit, por disa janë punuar edhe në periudhat e mëparëshme.

Në përbërjen e ekspozitës numërohen deri në 200 vepra piktore, skulpture dhe grafike; pamvarësisht që në të mungojnë të tilla lloje si arti i pllakatit, karikaturës, arti dekorativ i aplikuar; ekspozita jep prap se prap, në përgjithësi, një ide mbi degët kryesore të artit sovjetik.

Në ekspozitë janë paraqitur punë jo vetëm të mjeshtëreve të Federatës Ruse, qyteteve Moskë dhe Leningrad por edhe të artistëve të Ukrainës, Estonisë, Armenisë, Azerbaixhanit, Kazakistanit, që është një shembull i qartë i jetës së gjallë artistike në këto republika.

Punimet e mjeshtëreve sovjetikë të artit, të paraqitura në ekspozitë, janë të përshkuar nga një ideshmëri e thellë, besnike ndaj principeve të realizmit socialist. Së bashku me këtë, sejcili nga artistët e paraqitur, karakterizohet nga një mënyrë krijimi krejt personale, në të cilën ay punon.

Ekspozita ze tri salla dhe një koridor. Në sallën e parë të hyrjes, kush-tuar kryesisht pikturës së peizazhit dhe të portretit, janë ekspozuar gjithashtu vepra me tema historiko-revolucionare dhe historike, që zenë një vënd të dukshëm në krijimtarinë e artistëve sovjetikë. Ndërmjet këtyre veprave mund të përmenden më përpara tabloja e N. Osenevit «viti 1917», «Fjala e parë e pushtetit sovjetik — dekreti për paqë». Në këtë vepër artisti në mënyrë shumë ekspresive ka çfaqur rëndësinë historike të aktit të parë shtetëror të

pushtetit të ri të sovjetëve, për masat punonjëse.

Në sallë ekspozohet gjithashtu portreti i Vladimir Ilic Leninit në rini. Autorët me shumë përgjegjësi e kanë kapur temën e rëndësishme dhe kanë krijuar një figurë të thellë të prijsit të ardhshëm të proletariatit të të gjitha vendeve.

Piktori V. Zadorozhni i përket tabloja e madhe historike «Bogdan Hmelnicki e le peng të birin tek hani i Krimesë». Ndërmjet tablove të tjera historike të artistëve sovjetikë, që i kushtohen temës së Bogdan Hmelnickit në bashkimin e Ukrainës me Rusinë, kundër feudalëve polakë, tabloja e Zadorozhnit ze një vend nderi. Tabllotë e gjëra të ekspozuara në sallë i tregojnë spektatorit, larminë e peizazheve të mrekullueshëm të krahinave të ndryshme të Bashkimit Sovjetik dhe i njuh spektatorët me figura njerëzish sovjetikë.

Bukurija madhështore e hapësirave të pamatura të Vollgës ka shërbyer si një moment frymëzimi për piktorët A. Gricai, J. Remas, G. Nisski dhe të tjerët, që kanë krijuar peizazhe të paharruara të lumit të madh rus.

Piktorët B. Vitomski, V. Meshkov dhe R. Rjaznov janë paraqitur me tabllora që i kushtohen natyrës së egër por magjepsë të Karelisë Vendlit dhe Siberisë. Piktoria armen Gjylhian dhe piktori kirgiz Çujkov pikturojnë në tabllotë e veta peizazhe të vendeve jugore të atdheut tonë.

Shumë bukur ka dijtur të na japë në tabllonë «Ylberi mbi Dniepër» piktorja L. Brodskaia peizazhin e mrekullueshëm të lumit Dniepër në një moment kur rrezet e diellit çajnë retë duke ndriçuar pyjet e bregoret.

Ndër disa portrete të ekspozuara në sallë, portretistët sovjetikë përpiqen të tregojnë botën e pasur shpirtërore të njerëzve, të zbulojnë brenndinë e çdo figure. Këtu meritojnë të përmenden portretet ekspresivë të

punëtores Gllazunova — punë e Maksimovit; e poetit S. Marshak — punë e A. Gerasimovit; e kompozitorit J. Shaporin — punë e V. Efanovit, «Portret i një gruaje» — punë e V. Serovit.

Në pjesën e koridorit që të çon në sallën kryesore si edhe në vetë sallën kryesore janë përqëndruar vepra të ndryshme të pikturës dhe skulpturës kushtuar temave të ndryshme.

Katër natyra të qeta të piktorit të çuar sovjetik P. Konçalovski japin mundësi që të gjykosh mbi talentin e shkëlqyer të këtij artisti. Punët e vogla dhe të ndryshme por interesante të Kukriniksëve që janë ekspozuar së bashku me to, tregojnë qartë, se të tre mjeshtrat e talentuar të artit sovjetik (M. Kuprianov, P. Kriollov, M. Sokollov) janë jo vetëm krijorjës tablosh të mëdha, monumentale, historike, ilustronjës të mrekullueshëm librash dhe karikaturash të mprehta, por edhe peizazhistë të thelluar.

Në qëndër të sallës kryesore gjendet një grup shumë figurash «Duam paqë», ekzekutuar nga një brigadë skulptorësh me V. I. Muhinën në krye. Këtu ekspozohen gjithashtu dy portrete skulpturalë të themelonjësit të shtetit sovjetik — Vladimir Ilic Leninit, punë të skulptorëve N. Andreev dhe N. Tomski. N. Andreevi, krijonjësi i serisë së dëgjuar të portreteve të Leninit «Leniniana» e ka kapur Leninin në një moment të mbledhjes së Sovnarkomit, duke i dhënë karakteristikat e thella dhe besnike të figurës së prijsit. Një sukses të madh ka arrijtur edhe N. Tomski në portretin e tij, duke theksuar tiparet e Leninit si të një burri të madh shteti.

Nga veprat e tjera skulpturale të vendosura në sallën kryesore të ekspozitës është e domosdoshme të shënohen, portreti ekspresiv i partizanes Zoja Kosmogjemjanskaja dhe portreti i kolkozianit Nazarali Niazovi punuar nga skulptori E. Vuçe-

tiç, portreti i vajzës shqiptare Muazes Salice dhe i minatorit frërg Zhozef Helton, punë të skulptorit N. Tomski, dhe gjithashtu portreti ekspresiv i poetit të madh azerbajxhanas Nizami Ganxhevi, punë e skulptorit M. Mamedov.

Një tablo e madhe e piktorit V. Zadorozhni tregon për veprat heroike të rinisë së Krasnodonit, «Gardistët e rinj të lavdishëm». Artisti e ka quajtur veprën e vet «Ata janë të pavdekshëm» dhe me të vërtetë në kujtimin e popullit kurrë nuk do të vdesin veprat e tyre të lavdishme.

Temës së Luftës së Madhe Patriotike i kushtohet gjithashtu tabloja e vogël e B. Nemerokit «Për të largmit dhe për të afërmit», që tregon për çlodhjen e shkurtër të ushtarëve, për nierëzitet e afërt dhe të largët të luftëtarëve tanë.

Tema kolkoziane ka zënë vendin e saj të qëndrueshëm në veprat e artistëve sovjetikë. Kështu, p.sh., mieshtëri i njohur A. Pllaston është përfaqësuar në tabllonë e madhe, «Shiria e grurit», vëllezërit A. dhe S. Tkaçev kanë ekzekutuar tabllonë «Tek pushi».

Me vepra interesante kushtuar punimit të tokave të lëna djerrë janë paraqitur piktorët V. Baçev dhe V. Neçitajlo.

Peizazhe lirikë të Vollgës ka paraqitur H. Romadini, kurse piktori i njohur S. Gerasimov ka ekspozuar dy nga peizazhet më të thelluar të natyrës sonë ruse.

Një vend të rëndësishëm në ekspozitë i është dhënë veprave të llojit zhanër, që tashti është zhvilluar me sukses në artet figurative sovjetike.

Në ngjyra të përmbatura, me nërshtatshmëri përsa i përket kompozicionit dhe brendisë është tabloja e piktorit S. Gavrillov «Mai. Natë veriore» të mprehta dhe plot humor të lehtë janë tabllotë me tema mituristhe. Kështu janë tabllotë e F. Reshetnikovit «Riprovim»,

të M. Bozhit «Tania, mos luaj», të P. Oborinit «Suksesi i parë», J. Neprincevit «Ne fituam». Një rëndësi principale ka gjithashtu tabloja e artistit të ri leningradës L. Kimonski «Pas mbledhjes». Si veprën më të rëndësishme nga pikpamja aktuale në lëmin e llojit zhanër na dyshim duhet të pranojmë tabllorë e piktorit S. Grigoriev «U kthye». Guximi në shtruarjen e një proklamimi delikat të moralit socialist, zgjidhja me zotësi e temës përcaktojnë rëndësinë e madhe edukative të tabllorës.

Në një sallë të veçantë dhe në një pjesë të koridorit ekspozohen vepra të grafistëve sovjetikë. Mbi temën e punës socialiste në industri, në ndërtime, në ekonominë shoqërore punonjë me sukses N. Ponomarevi, dhe V. Cigali dhe gjithashtu V. Mironenkua dhe V. Bogatkini. I. Sisoevi dhe të tjerë. Interesantë janë akuarelet që pasqyrojnë skena nga jeta e Kinës popullore, të krijuar nga A. Gerasimov.

Të mrekullueshëm, të thellë nga ana e karakteristikës psikologjike janë portretet e njerëzve sovjetikë — balerinës Galina Ulanova, punëtorit të shtypshkronjës Pozhilov, akademikut I.A. Oparin të ekzekutuar nga grafisti i kujdesëshëm sovjetik G.S. Verejski.

Gjërësisht është paraqitur në ekspozitë arti i ilustrimit të aplikuar, ku punonjë shumë mieshtë të talentuar të artit sovjetik. Një sukses të merituar gëzojnë ilustrimet e ekzekutuara në mënyrë të mrekullueshme nga Kukriniksët për romanin e pavdekshëm të M. Servantes «Don-Kishoti». Këtu është e rëndësishme të nënvizohet se artistët e kanë kuptuar drejt tingëllimin ideologjik të librit të M. Servantes, esencën e tij artistike. Me një lirizëm të jashtëzakonshëm dhe poezi, piktori D. Dubinski ka dijtur, të cotë ilustrimet e tija të mrekullueshme për tregimin e A.P. Cehovit «Shtëpia me mezanin», çeri në bukurinë e plotë magjepsë të kësaj veprë.

Një sukses i padiskutueshëm historik duhet të konsiderohen ilustrimet e ekspozuara të E. Kibrihut për tregimin e N.V. Gogolit «Taras Bulba» dhe tregimin e R. Rolandit «Kola Brënjon».

Ndihet në mënyrë të dalluar talenti i shkëlqyer i piktorit V. Favorshi në ilustrimet e tija për «Fjalën e ushtrisë së Igorit» dhe dramën e Pushkinit «Boris Gudunov».

Përveç të gjitha këtyre punimeve në ekspozitë janë paraqitur ilustrimet për librat me cilësi të lartë artistike të D. Shmarinovit, O. Verejskit, A. Llapitievit dhe shumë të tjerëve.

Në sallën e grafikës dhe në koridor ekspozohen edhe disa vepra skulpture. Dy portrete skulpture të V.I. Leninit punuar nga N. Andrevi mishërojnë tiparet e prijsit të madh. Demokratit të përparuar

Suksesi i artistëve të rinj të baletit në Teatrin tonë popullor

Mbrëmjen e 20 Tetorit, në prani të udhëheqësve të Partisë e të Qeverisë si dhe të një publiku të shumë, artistët e rinj të baletit, që porsa kanë kryer studimet në Bashkimin Sovjetik debutuan për herë të parë në skenën e Teatrit Popullor. Programin e filluan solistët Ganimet Vendresha dhe Xhemil Simixhiu, të cilët ekzekutuan nga baleti «Liçeni i mjellmëve» i kompozitorit të madh rus Çajkovski adagion nga akti i dytë. Interpretimi i këtij numuri u krye me karakterin e duhur dhe me shumë ndjenjë. Ganimet Vendresha në partin' e Odetës si dhe më vonë në Valsin nr. 7 të Shopenit me partëner Petrit Vorpsi u tregua artiste e talentuar me shumë karakter e element lirik në vetvehte. Xhemil Simixhiu si n'adagion e Çajkovskit ashtu dhe në variacionin e tij «Kali gërmuq» nga Punji tregoi një maturi teknike të theksuar duke u paraqitur njëkohësisht si figurë mjaft e rëndësishme dhe interesante në skenë.

dhe filozofit rus A.I. Hercen dhe studjonjësit të polit Çeljuskin i kushtohen punët e skulptorit I. Veropai dhe V. Çebotarev.

Miqësija vllazërore ndërmjet popujve të Shqipërisë dhe të Bashkimit Sovjetik është e pathyeshme. Një rëndësi shumë të madhe në zhvillimin e kësaj miqësie ka bashkëpunimi kultural dhe pjesërisht njohja reciproke me sukseset në lëmin e artit. Jemi të bindur se ekspozita e arteve figurative sovjetike në Shqipëri është një hap i ri në rrugën e përfundimit të miqësisë ndërmjet të dy popujve.

Drejtori i ekspozitës së arteve figurative sovjetike
J. Miller

Me simpati të madhe u pritën nga publiku çifti i talentuar Zoica Haxho dhe Agron Alija, të cilët ekzekutuan me shumë përpikmëri lëvizjesh, frazash, kadencash dhe më tepër se kaq me shumë elegancë dhe ekspresion «Pa de de» nga baleti «Kujdes i kotë» nga Gertel dhe sidomos Pa de de nga baleti Don Kishot i kompozitorit Minkus, duke gëzuar duartrokitjet e stuhishme të gjithë sallës. Zoica Haxho e Petrit Vorpsi patën sukses të madh me ekzekutimin e «Valsit të të rinjve» nga kompozitori sovjetik Shumkler, duke e kërcyer këta me shumë shkëlqësi, gjallëri e jetë dhe teknikisht të sigurtë. Petrit Vorpsi kërcëu edhe variacionin nga baleti «Liçeni i mjellmëve». U pëlqye shumë vallja moldavjane kërcyer me temperament e k'artësi nga Zoica Haxho Agron Alija e Petrit Vorpsi.

Në programin e kësaj mbrëmje bënë pjesë edhe këngëtorë e instrumentistë të tjerë. Këngëtorja e re Hamide Stringa e cila mbaroi studi-

met në Bashkimin Sovjetik këndoi nga kompozitori Grig «Zambaku i ujit», këngën popullore shqiptare përpunuar nga Çesk Zadeja «Bleva një kavall t'argjent» dhe arien e Margaritës nga opera Faust e Guno. Asaj iu pëlqye më tepër aria e Margaritës dhe kënga popullore shqiptare, të cilat u paraqitën si më mirë t'impotuara po kështu dhe nga ana e interpretimit.

Këngëtori Luk Kaçaj kontribuoi shumë për suksesin e asaj mbrëmjeje. Ai këndoi me sentiment, kulturë e me karakterin e duhur të tri pjesët e tij, ndër to më mirë kavatinën e Alekos nga opera me të njëjtin emër të kompozitorit Rahmani-nov, po kështu dhe arien e Don Bazilios nga Opera «Berberi i Siviljes» e kompozitorit italian Rossini. Me interpretimin e asaj nate, Luk Kaçaj u tregua artist mjaft i pjekur e profesionist serioz.

Ndër instrumentistët pati shumë sekses violoncelisti Ymer Skënderi, i cili ekzekutoi Rondo nga Bokerini, melodi e valles shqiptare të përpunuara nga ay vetë dhe Çaltarello nga Goenenoti. Në pjesët e tij Ymer Skënderi tregoi pjekuri, talent e siguri të gjithanshme.

Violinisti Genc Bogdo që luajti nga Mozart kohën e parë të koncertit në La Maxhore për violinë e orkestër dhe pjesën «Nga vendi im» të kompozitorit të madh çek Bedri Smetana u pëlqye shumë sidomos në veprën e Smetanës, të cilën e interpretonte mirë dhe me shumë ekspresion. Sukses korri dhe violinisti i

talentuar Islam Petrela në të dy pjesët e tij «Elegji» nga Dvarionas dhe valle nga Moshkovski për ekzekutimin e tij të pastër dhe mjaft muzikal.

Në këtë koncert me program m'afit të gjërë e me shumë përgjegjësi artistike nuk mund të lihet pa u përmendur shoqërimi shumë mirë e i ngrohtë i pianistes së talentuar Margarita Kristidhi, e cila që për gjithë koncertin dhe interpretonjësit një ndihmëse e çmuar. Mirë shoqëruan respektivisht për pjesët e tyre pianistja Lili Tafaj dhe violinisti e violonçelisti Manush Agimi e Mateo Guralumi.

Artistët e rinj të baletit si dhe solistët e tjerë e mbyllën koncertin e tyre me përshtypjet më të mira të publikut e në ngrohtësinë e një entuziazmi të madh. Artistët tanë të rinj u treguan në lartësinë e talentit të tyre duke premtuar suksese të mëtejshme e më të mëdha në karrierën e tyre të vështirë po të bukur. Krijimi dhe edukimi i këtyre talenteve në shkollat e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore është një dëshmi e kujdesit të madh që tregon Partija jonë e dashur për zhvillimin e arteve dhe të kulturës në Republikën tonë. Le të jetë kjo mbrëmje për artistët e rinj pikënisja për suksese më të mëdha në dobi të lulëzimit të mëtejshëm të artit dhe të kulturës sonë të re nacionale nga forma dhe socialiste nga përmbajtja.

Mustafa Krantja

Përkujtohet 350 vjetori i lindies së piktorit të madh hollandez Rembrand Van Rijn

Komiteti shqiptar për mbrojtjen e paqes dhe Lidhja e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë organizuan më 13 tetor në sallën e Bibliotekës Kombëtare një mbledhje kushtuar 350 vjetorit të lindies së piktorit të madh hollandez Rembrand Van Rijn, në të cilin foli shoku Foto Stamo, sekretar i Komitetit drejtoniës provizor të Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

Në mbledhje merrnin pjesë piktorë, skulptorë, nxënës të Liceut artistik e të tjerë.

Ndodhej gjithashtu nën kryetarja e Komitetit Shqiptar për mbrojtjen e paqes, shoqja Fiqirete Shehu.

Shoku Foto Stamo foli mbi jetën dhe veprimtarinë krijonjëse të piktorit të madh hollandez.

Ai e cilësoi atë si një artist të madh dhe punëtor të palodhur i cili ishte përfaqësues i vërtetë i shpirtit popullor hollandez. «Veprat dhe krijimtaria e Rembrandit, tha shoku Foto Stamo tërheqin vëmendjen e punonjësve të artit dhe të kulturës së vëndit tonë për trajtimin e tyre të lartë artistik. Punonjësit e artit shqiptar kanë për të

Mbledhje kushtuar 20 vjetorit të vdekjes së shkrimtarit të madh kinez Lu Sin

Më 19 tetor Lidhja e Shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë organizoi në sallën e Bibliotekës Kombëtare një mbledhje kushtuar 20 vjetorit të vdekjes së shkrimtarit të madh kinez Lu Sin.

Në mbledhje merrnin pjesë shkrimtarë, artistë dhe punonjës të artit dhe kulturës. Ndodhej gjithashtu i ngarkuari me punë a.i. R.P. të Kinës në R.P. të Shqipërisë Van Dun si dhe funksionarë të tjerë të ambasadës.

Mbledhjen e hapi shoku Dhimitër Shuteriqi kryetar i Komitetit drejtonjës provizor të Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, i cili theksoi ndër të tjera se së bashku me popullin kinez gjithë popujt liridashës në botë përkujtojnë me nderim të thellë 20 vjetorin e vdekjes së Lu Sinit, themeloniësit të letërsisë së re kineze, luftëtarit të madh që u përpoq për afirmimin e letërsisë me realitetin, me jetën, me popullin, duke e bërë letërsinë armë të fuqishme rë shërbim të popullit. Pastaj iu dha fjala shkrimtarit Fatmir Gjata antar i Komitetit drejtonjës provizor të Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

Shoku Fatmir Gjata foli mbi jetën, punën dhe veprimtarinë krijuese të Lu Sinit, për përpjekjet e

mësuar shumë nga veprat dhe jeta e këtij kollosi të pikturës. Ne përkujtojmë me respekt të madh piktorin hollandez Rembrand Van Rijn, këtë figurë të çqar të artit botëror.»

Pastaj të pranishmit vizituan ekspozitën me riprodhime nga veprat e Rembrandit.

Përkujtimet të piktorit të madh hollandez i janë kushtuar gjatë muajve të shkuar edhe disa artikuj në organet e shtypit qendror.

tij të gjithëanëshme që të ngjallë ndërgjegjen kombëtare tek populli liridashës kinez, që qe lënë në prapambetje prej shekujsh nga sundonjësit e tij, duke përdorur armën e fuqishme të letërsisë e të artit. Folësi theksoi luftën e papërkulur që bëri ky shkrimtar e patriot i madh kinez për çështen e popullit të Kinës, foli për ndihmën e çmuar të Lu Sinit në luftën vëndimtare që filloi populli kinez, me klasën puntore në krye, kundër reaksionit të brendshëm e të jashtëm. Folësi tregoi e se si përballë letërsisë reaksionare dekadente që kërkonte të helmatishte shpirtin e popullit kinez, Lu Sini me veprat e tij të shumta, me tregimet, shkrimet publicistike, fejtoret, kritikën, studimet vuri si hero kryesor popullin me tërë vuajtjet e tij, me hakmarrjen dhe urrejtjen e tij kundër sistemit shtypës e skllavërues feudalo-kolonialist, me shprestat e tij për një të ardhme më të mirë. Pastaj shoku Fatmir Gjata përmendi veprat e Lu Sinit, rolin e tyre të madh edukativ e mobilizojnës, kontributin që dha ky shkrimtar jo vetëm me venrat e tij origjinale po edhe me përkthimet që bëri nga letërsia përparimtare botnore, në radhë të parë nga letërsia ruse dhe sovjetike, e sidomos veprat e M. Gorkit.

Pas fjalës së shokut Fatmir Gja-

ta shkrimtarët Andrea Varfi dhe Llazar Siliqi recituan pjesë nga veprat e shkrimtarit kinez Lu Sin.

Me rastin e këtij përvjetori në

Një piktor gjerman në vëndia tonë

Në muajin shtator erdhi në vëndin tonë, në mbështetje të konventës kultrale me R.D. Gjermane, piktori i njohun gjerman, antar i presidiumit të Lidhjes së Artistëve Gjermanë shoku Tom Beyer.

Ai ndenji në Shqipëri gjashtë javë dhe vizitoi disa nga qytetet tanë: Tiranën, Durrësin, Krujën, Vlorën dhe Elbasanin. Gjatë kësaj kohe ay pikturoi një numur pamjesh karakteristike me peizazhe të arkitekturës së vjetër, me skena nga pazaret, duke u tërhequr më fort nga originaliteti etnografik. Ai është një piktor që punon me njolla të përgji-

Shkrimtari Sterjo Spasse në R. P. të Kinës dhe në R. P. të Mongolisë

Me rastin e jubileut të 20 vjetorit të vdekjes së shkrimtarit të madh Lu Sin, themelonjës i letërsisë realiste kineze, më 12 tetor u nis për në R.P. të Kinës, i ftuar nga Lidhja e shkrimtarëve kinezë, shkrimtari Sterjo Spasse, laureat i Çmimit të Republikës dhe antar i Komitetit Drejtonjës provizor të Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

Po kështu në bazë të planit kultural për vitin 1956 në mes të R.P.

Për zgjerimin e lëvizjes artistike diletante në radhët e punëtorëve

Puna kulturalo artistike në radhët e punëtorëve ka ardhur gjithënjë duke u shtuar dhe përmirësuar. Çdo ditë në këtë punë aktivizohen elementë të rinj, të cilët me punën e tyre ndihmojnë për zhvillimin kultural e artistik të masave. Për këtë qëllim shpesh herë zhvillohen festivale lokale të muzikës, këngës dhe valleve. Në gusht të vitit 1957 do t'organizohet në vëndin tonë fes-

një kënd të sallës së bibliotekës ishin vendosur fotografi nga jeta e Lu Sinit dhe veprat e tij në gjuhën kineze, shqipe dhe në gjuhë të tjera.

thëshme, pa hollësira, duke arrijtur kështu edhe në efekte të përgjithëshme.

Gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri ay u takua me artistë shqiptarë dhe u foli atyre mbi eksperiencën e artistëve gjermanë në punën e organizimit të veprimtarisë së tyre krijonjëse.

Galerija e Arteve Figurative në Tiranë, mori nga shoku Tom Beyer, një nga peizazhet e punuara në vëndin tonë.

Me 12 tetor piktori gjerman Tom Beyer u largua nga Shqipëria.

Shqipërisë dhe R. P. të Mongolisë, shkrimtari Sterjo Spasse do të vizitojë R.P. të Mongolisë.

Shkrimtari Sterjo Spasse u përcuall n'aeroport nga sekretari i Komitetit drejtonjës provizor të Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, Llazar Siliqi dhe nga shkrimtarë të tjerë. Kishte dalë gjithashtu për ta përcjellë ate edhe sekretari i ambasadës kineze Çan Ven.

tivali kombëtar i muzikës, këngës dhe valleve.

Për këtë qëllim dhe që të zhvillohet e përhapet sa më gjërë aktiviteti i grupeve të amatorëve të gjinive të ndryshme t'artit në qendrat e punës dhe të prodhimit dhe për të nxitur e inkurajuar këto grupe për të zhvilluar një aktivitet sa më të gjërë e të mirë për punonjësit, Këshilli qëndror i Bashkimeve profesionale

sionale të Shqipërisë ka shpallur një konkurs.

Në këtë konkurs do të marrin pjesë qarqet, rrethet dhe qendrat kulturele të bashkimeve profesionale.

Për fitonjësit e konkursit janë vënë çmime të ndryshme.

Qarqet e rrethet janë ndarë në dy kategori dhe për çdo kategori, dy çmime, ndërsa qendrat kulturele (klubet e këndet e kuq) janë ndarë në katër kategori. Për qarqet e rre-

Sukses i madh i grupit të baletit të Teatrit Balshoi në Angli

Kritikat teatrale të gazetave të Londrës e lavdërojnë shumë baletin «Liqeni i Mjellmeve», të vënë në skenë nga grupi i Teatrit Balshoi më 8 tetor.

Kritiku i gazetës «Deili Herald» Endriu Smith e cilëson këtë çfaqje si «një ngjarje tjetër të madhe në fushën e baletit».

Sipas gazetës «Deili Uorker» çfaqja pati një sukses «kolosal».

Gazetat nuk u kursejën lavdërimet ekzekutuesve kryesorë dhe regjizorit Fajer. Kritiku i gazetës «Deili Herald» komenton me admirim mjeshtërinë e balerinës së re, N. Timofejeva, e cila ekzekutoi rolin e Odetes Odilias në baletin «Liqeni i Mjellmeve». Ai thekson se ajo i meriton brohoritjet më të mëdha që ka marrë ndonjë artiste në Operën Mbretërore... Teknika e saj është e shkëlqyeshme, dhe ajo është e bindur dhe e sigurtë në vehten e saj, si një balerinë që ka eksperiencën më të madhe. Ajo ka një stil karakteristik, ka stilin e saj të veçantë.

Kritiku i gazetës «Njus Kronikell» shkruan se N. Timofejeva «është një balerinë që premtan jashtëzakonisht shumë, një balerinë e shkëlqyeshme prej natyre».

Kritiku i gazetës «Deili Uorker», Xheik Koks, duke e cilësuar si të «shkëlqyeshme» teknikën e balerinës N. Timofejeva, shkruan se në «Teatrin Balshoi brezi i ri i vallë-

thet e kategorisë së parë çmimi i parë është flamuri i festivalit kombëtar i shoqëruar me 30.000 lekë dhe çmimi i dytë një diplomë shoqëruar me 20.000 lekë.

Për klubet e kategorisë së parë ka një çmim: një diplomë të shoqëruar me një orkestrinë popullore komplet. Por klubet e kategorisë së dytë, të tretë dhe këndet e kuq do të ketë nga tre çmime.

zuesve nuk ka mbetur prapa. Dytshohet në se në «kenën» e teatrit të Kovent-Garden do të dalë ndonjë herë një Odete e tillë e re dhe e gjallë».

Autori i një recensioni të botuar në gazetën «Ivning Njus», duke lavdëruar shumë interpretimin e Nina Timofejevas, shkruan se «ajo interpretoi një rol të dyfishtë me një ndjenjë shumë të hollë, ajo një herë paraqiti Odeten e ëmbël, të butë, të pafajshme dhe të bukur, pastaj Odilian e ftohët, të shkëlqyeshme dhe ngadhënjimtare.

Një përshtypje jo më të vogël të lë partneri i saj, Nikollaj Fadejeçev, në interpretimin e të cilit Sigfridi doli jashtëzakonisht trim dhe energjik... Ai na tregoi mjeshtërinë e tij në disa valle në aktin e tretë, duke paraqitur lehtësinë dhe mjeshtërinë, madhështinë e valleve të një burri. Lukej sikur në kërcimet e tija ai ngrihej në ajër, pas'aj qëndronte atje për një çast si i ngrirë, zbriste lehtë në tokë, dhe të gjitha këto i bënte me ritmin e muzikës».

Duke bërë fjalë për interpretuesit e tjerë dhe për muzikën, kritiku i gazetës «Tajms» shkruan: «Rrotullimet e stuhishme të Farmanianc, eleganca e lëvizjeve të Marina Kondratjevas në pade-trua, kërcimet vjedhurazi të Levashovit, — të gjitha këto role dhe rolet e tjera më të rëndësishme, si edhe arti i frymëzuar i regjizorit Fajer krijojnë një

variant të gjallë dhe tërheqës, rëndëse të diskutueshëm të kësaj veprë gjeniale.

Heskells në «Deili Meil» arrin në konkluzionin se «me të vërtetë e gjithë çfaqja është jashtëzakonisht e gjallë, sidomos në aktin e tretë dhe interpretuesit i merituan plotësisht duartrokitjet e korrura prej tyre».

Duke krahasuar «Liqenin e Mjellmeve», të vënë në skenë nga Teatri Balshoi, me variantin englez të këtij baleti, gazeta «Tajms» thekson ndryshimet kryesore dhe shkruan: Argumenti më i rëndësishëm në favor të variantit Rus është stili i tij, i cili pothuajse në të gjithë pikpamjet i përgjigjet partiturës së Çajkovskit».

Stili i kërcimeve është plot zjarr dhe pasion në krahasim me stilin e baletit «Selders-Uells».

Gazeta «Deili Uorker» shkruan për «nivelin e lartë artistik të koreografisë së Gorskit, i cili që... një argument i shkëlqyeshëm kundër pohimit se gjoja idetë krijuese ikën nga Rusia së bashku me Diagilevin dhe Fokinin».

Gazeta «Ivning Njus», duke deklaruar me admirim se grupi i Teatrit Balshoi është «grupi i baletit më i mirë dhe më i shkëlqyeshëm që kemi parë ndonjëherë, bën disa vrej-tje kritike në lidhje me vënien në skenë.

Sipas gazetës «Njus Kronikell», «Liqeni i Miellmeve» i vënë në skenë nga Teatri Balshoi, tregoi shumë të papritura dhe shkaktoi një kënaqësi shumë të madhe. Ana dramatike e tregimit nuk është lënë pas dore dhe vallet janë një ndjekje llogjike e saj». Gazeta shton: «Akti i tretë është i shkëlqyeshëm edhe dekoracionet u pritën me brohoritje. Në vënd të mjeshtrit të ceremonive mjaft të mërziqshëm këtu paraqet një bufon, i cili interpretohet në mënyrë të shkëlqyeshme nga Goergi Farmanianc. Nikollaj Fadejeçev i dha një karakter të veçantë rolit të princit Sigfrid.

Por ndofta përshtypjen më të madhe e shkaktoi skena e fundit e cila zakonisht kalon pa u vënë re... Ajo është kulmi i të gjithë baletit».

Grupi i baletit i teatrit Balshoi shënoi një tjetër sukses të madh në mbrëmjen e 9 tetorit, kur çfaqja baletin e Asafjevit «Shatrivani i Bahçisarajt» në shtëpinë mbretërore të operas Kovent Garden.

Interpretimi i përsosur i artistëve sovjetikë rrëmbeu që në fillim vëmëndjen e të pranishmëve. Duartrokitje të stuhishme dhe brohoritje plot entuziazëm përhëndeën vallëzimin e bukur të Marias (Raisa Struçkova) dhe të Vaklavit (Juri Kondratov), polonezen e rjedhëshme, mazurkër: e gjallë dhe krakoviane e shpejtë.

Bashkëfjalime të gjata rreth baletit rus dhe mjeshtërisë së madhe të artistëve sovjetikë u zhvilluan në korridoret e teatrit gjatë pushimeve.

Një shpërthim i duartrokitjeve e mbuloi sallën në fillim të aktit të dytë në lidhje me përgatitjen e mrekullueshme të skenës. Raisa Struçkova (Maria), Aleksandër Lapauri (Girei) dhe artistet e tjera u duartrokitën nxehtësisht.

Akti i tretë dhe i katërt kishin po aqë sukses. Vallja e ushtarëve të Kanit u prit me duartrokitje të fuqishme. Shumë kohë pasi u ul perdja, të pranishmit qëndronin në sallë duke u bërë valltarëve të baletit një ovacion të përzemërt.

Në mbrëmjen e 12 tetorit kur qindra londinezë drejtoheshin për në hyrjen e ndriçuar të teatrit mbretëror të operas «Kovent Garden», nga të gjitha anët dëgjoheshin fjalë krejt të jashtëzakonshme për Londrën: «Mos keni juve ndonjë biletë të tepërt?» Ata që nuk kishin mundur të gjejnë bileta për çfaqjen nga grupi i baletit të Teatrit Balshoi «Zhizhel» nuk i kishin humbur akoma shpresat për një «rast të lumtur».

Nëpër rrugët, që shpien në teatër, në karrike portative si dhe në parma-

kë prej guri gjendeshin admironjësit e baletit, të cilëve iu desh të rinin në radhë gjithë natën dhe një pjesë të madhe të ditës — pothuajse 24 orë — për të patur mundësinë qofitë edhe në këmbë të shikojnë çfaqjen e dytë të «Zhizhel» në mbrëmjen e 13 tetorit.

Gazeta «Deili Telegraf end Morning Post» njohton më 13 tetor se 2.000 spektatorë, të cilët u bënë një ovacion të stuhishëm mjeshtrëve të baletit sovjetik, «asisuar në një ngjarje me rëndësi tepër të madhe». Kritiku i baletit të kësaj gazete Kolon, shkruante se me sa kujtonte ai «në skenën e Londrës nuk është çfaqur asgjë që të mund të krahasohet me baletin «Zhizhel» të çfaqur nga Teatri Balshoi. Kritiku i gazetës «Deili Meil» Arnold Haskel shkruante: «Nuk gjejmë fjalë që të mund të përshkruajmë këtë ngjarje aqë madhështore në jetën teatrale». «Në baletin «Zhizhel», shkroi kritiku i gazetës «Njus Kronikël» Elizabeth Frank, Teatri Balshoi arriti kulmin e triumfit të tij».

Një entuziazëm të veçantë u shkaktoi kritikëve, Ulanova në rolin e vajzës fshatare Zhizhel. «Kur shikojmë një artiste të tillë si Ulanova, gjuhës së zakonshme të kritikës i mungon forca, dhe bile duartrokitjet tingellojnë si një ndërhyrje e ashpër në enigmën e këtij arti madhështor, shkruajti kritiku i gazetës «Deili Meil». Artikulli i tij ai e përfundoi me fjalët e drejtorit të përgjithshëm të teatrit «Kovent Garden» Devic Uebster se «Ulanova është një mrekulli».

Kritiku i gazetës «Deili Telegraf end Morning Post» shkruante: «Përsosmënia e kërcimit të Uljanovës nga çdo pikpamje është e pakrahueshme».

Gazeta «Tajms» thekson gjithashtu se Ulanova ka krijuar një «Zhizhel që nuk mund të krahasohet», dhe se «ajo ka një lehtësi lëvizjesh që nuk mund të merret me mend».

Shtypi britanik konsideroi si një sukses të madh gjithashtu dhe mje-

shtërinë e madhe të të gjithë grupit të baletit të Teatrit Balshoi. Gazeta «Tajms» shkruante se akti i dytë në «Zhizhel ishte një provë e shkëlqyeshme e nivelit të lartë të baletit» dhe një «shëmbëll i çuar i lirizmit dhe rjedhshmërisë së të gjitha valleve». Kriuaku i gazetës «Deili Telegraf end Morning Post» theksoi gjithashtu se «të gjithë pjesëmarrësit e baletit vepronin në një menyre harmonike dhe si rezultat ne shikojmë një çfaqje me një forcë dhe një thellesi maneshitore».

Një numur gazetash britanike të 14 tetorit çmuanë snume çfaqjet e grupit të baletit të teatrit akademik shtetëror Balshoi të Bashkimit Sovjetik në Londër.

Në një artikull me titull «Një grup i çuar» kritiku i gazetës «Obzerver» A. Blend tregoi përshtypjet e tij mbi baletin «Zhizhel». Në këtë çfaqje, ku Ulanova luajti rolin kryesor, shkruante ai, kërcimet arrijnë në përsosuri të pabesueshme dhe vënia në skenë të magjeps me të vërtetë. Kërcimi i Uljanovës në aktin e parë të bën për vehte. «Uljanova tregoi përsëri atë aftësi, që ne pamë edhe në «Romeo e Xhulieta», duke çfaqur çdo ide të saj me një qartësi prej kristali»... Blend flet me entuziazëm mbi të gjithë pjesëmarrësit e çfaqjes dhe thekson se në baletin «Zhizhel» grupi i çuar tregoi gjithë madhësinë e tij në një çfaqje të paharruar.

Me çfaqjen e baletit «Liqeni i Mjellmeve» të Çajkovskit muarën fund çfaqjet e grupit të baletit të teatrit shtetëror akademik Balshoi të Bashkimit Sovjetik në skenën e teatrit mbretëror të operës «Kovent Garden» në Londër.

Spektatorët e pritën këtë çfaqje të mjeshtrëve të baletit sovjetik me një nxehtësi dhe përzemërsi të veçantë. Në mbarim të çfaqjes ata u bënë një ovacion të vazhdueshëm artistëve.

Më 28 tetor pjesëmarrësit e turneut të teatrit shtetëror akademik Balshoi të Bashkimit Sovjetik shkuan në vërdlindjen e dramaturgut të madh britanik Shekspir në qytetin

Startford On Eivon. Vizita u kthye në një shprehje të kuartit të ndjenjave miqësore të qytetarëve britanikë për artistët sovjetikë. Kudo që shkuan artistët sovjetikë, në shtëpinë ku lindi dramaturgu i madh, në kishën e lashtë, ku është varrosur ai, në teatrin e Shekspirit, kudo u përshëndetën nga turma banorësh të shumtë të qytetit dhe turistë.

Pas dite mysafirët asistuan në çfaqjen e «Othello», e cila u çfaq posaçërisht për ata në skenën e teatrit «Shekspir» nga grupi i artistëve i cili çregjtohej nga regjizori i çuar Antoni Kueil. Ekzekutimi i bukur dhe venia e përsosur në skenë u bënë një përshtypje të madhe mysafirëve sovjetikë të cilët i duartrokitën nxehtësisht artistët. Pas mbarimit të çfaqjes artistët sovjetikë shkuan në klubin e teatrit, ku për nder të tyre u dha një pritje nga drejtori i administratës së teatrit Lordi Ilif. Në pritje ishin të pranishëm afro 800 mysafirë ndërmjet të cilëve kishte shumë përfaqësues të çuar të artistit britanik. Duke iu drejtuar artistëve sovjetikë me një fjalim përshëndetje Lordi Ilif, tha se çfaqjet

Zgjerimi i lidhjeve midis shkrimtarëve sovjetikë dhe të huaj

Lidhjet e shkrimtarëve sovjetikë me letrarët e vëndeve të huaja po zhvillohen me sukses. Tani në Bashkimin Sovjetik gjinden shkrimtarë nga Hungaria, Argjentina, Italia, Irlanda, Egjipti dhe Jugosllavia. Gjer në fund të vitit priten të vijnë shkrimtarë nga Rumania, Bullgaria, Gjermania perëndimore dhe vende të tjera. Mysafirët e huaj marrin pjesë në bisedime dhe në diskutime që zhvillohen në Lidhjen e shkrimtarëve të Bashkimit Sovjetik. Në këto diskutime preken

e tyre në Britani «kanë një rëndësi të madhe». Ai shprehu shpresën se bashkëpunimi kultural midis Bashkimit Sovjetik dhe Britanisë do të zgjerohen.

Kryetari i këshillit të teatrit For-dem Flauer, në një fjalim të shkurtër shprehu admirimin e tij për shkak të interpretimit aq të hollë nga artistët sovjetikë të baletit «Romeo dhe Xhulieta» të figurave shekspiriane. Në fjalimin e përgjigjes drejtori i Balshoi Teatrit M.I. Culak i falënderoi përzemërsisht për pritjen e nxehtë. Ai theksoi se populli sovjetik admiron dhe e nderon Shekspirin.

Culaki tha se tani kompozitorët sovjetikë po pregatisin libretin muzikal për baletin «Othello».

Drejtori i teatrit «Shekspir» Glen Bajen Shou u dha artistëve sovjetikë një album me fotografi; në të cilin paraqiten skena të ndryshme nga çfaqja «Othello», Drejtori i Balshoi Teatrit M.I. Culaki nga ana e tij i dhuroi dhurata artistëve britanikë. Pritja kaloi në një atmosferë jashtëzakonisht të nxehtë dhe të përzemërt. Vonë në mbrëmje artistët sovjetikë u kthyen në Londër.

probleme të rëndësishme të literaturës, roli i saj në luftën për paqën dhe miqësinë midis popujve.

Shkrimtarët sovjetikë nga ana e tyre shkojnë në vende të ndryshme ku vendosin kontakte direkte me kolegët e tyre. Një komitet i posaçëm i Lidhjes së shkrimtarëve të Bashkimit Sovjetik dërgon në të gjitha anët e botës revista letrare dhe libra të shkrimtarëve sovjetikë. Nuk ka ditë që në adresë të këtij komiteti të mos vijnë pako me libra.

Dekada e kulturës Ukrainase në Poloni

Dekada e kulturës Ukrainase që po zhvillohet në Poloninë popullore demokratike, po i afrohet mbarimit.

Në lidhje me dekadën në qytete dhe fshatra të të gjithë vëndit organizohen mbremje, lexohen leksione dhe raporte kushtuar Ukrainës sovjetike. Leksionet lexohen nga shkencëtarë, profesorë të shkollave të larta, shkrimtarë, inxhinjerë, specialistë të bujqësisë. Ditët e fundit në qytete të ndryshme janë lexuar leksionet: «Ukraina e sotme», «Kultura e Ukrainës sovjetike», «Muzika e sotme e Ukrainës», «Teatri i Ukrainës», «Piktura e Ukrainës» dhe shumë leksione të tjera. Artistë të njohur nga Ukraina marrin pjesë në çfaqjet që organizohen në qytete të ndryshme të vën-

Në Moskë u hap një ekspozitë mbi historinë e artit dhe të letërsisë së Egjyptit

Një ekspozitë e librave mbi historinë e artit dhe të letërsisë së Egjyptit u hap me 10 tetor në bibliotekën e letërsisë së huaj të Bashkimit Sovjetik. Libra të autorëve egjyptianë zënë një vënd me rëndësi në ekspozitë.

Biblioteka ka marrë lart nga 200 libra në gjuhën arabe siatë gjashtë muajve të fundit, duke përfshirë vepra nga autorë bashkëkohëtarë egjyptianë si Taha Husein, Mahmut Teimur, Taufik al Hakim dhe të tjerë.

Monografitë dhe koleksionet e artikujve mbi prozën dhe poezinë

Në Bashkimin Sovjetik filloi festivali i dytë i filmave indianë

Më 29 tetor filloi në vëndin sovjetik festivali i dytë i filmave indianë i organizuar nga ministria e kulturës së Bashkimit Sovjetik. Festivali zhvillohet në Moskë, Leningrad dhe Baku.

Filmat indianë të cilët tregojnë jetën e njerëzve të thjeshtë të In-

dit. Solisti i teatrit akademik të operës dhe të baletit të Kievit «T. G. Shevçenko», artisti i popullit i Bashkimit Sovjetik B. Gmira egzekutoi pjesën e Mefistofelit në çfaqjen e operës «Faust» në operën shtetërore të Varshavës. Solisti i teatrit shtetëror akademik të operës dhe të Baletit në Lvov P. Karmalik mori pjesë në operën «Knjaz Igor» në teatrin shtetëror të operës «Moniushko» në Poznan. Në Varshavë gjëndet gjithashtu artistja e popullit e Bashkimit Sovjetik K. Çavdar.

Dekada e kulturës ukrainase në Poloni, thekson shtypi polak është një demonstrim i gjallë i miqësisë së përhershme midis të dy vëndeve fqinjë.

arabe janë pritur me interesim nga studentët e letërsisë lindore.

Midis veprave mbi historinë e shtetit egjyptian, ekspozita paraqet vepra nga shkencëtarë të shquar bashkëkohëtarë egjyptianë, duke përfshirë libra nga Rashid Al Barravi. Ekspozita paraqet gjithashtu libra në gjuhët gjermane, frënge, engleze dhe gjuhë të tjera mbi artin e vjetër të Egjyptit, arkitekturën dhe kulturën e tij. Ekspozita paraqet gjithashtu gazeta dhe revista egjyptiane, të cilat biblioteka i merr rregullisht.

disë, kanë fituar popullaritet midis spektatorëve sovjetikë. Ata kanë parë shumë filma të regjizorëve indianë. Në ekraneve e Bashkimit Sovjetik janë çfaqur me sukses filmat indianë: «Detyra», «Lundra», «Ganga» dhe të tjerë.

Gjatë ditëve të festivalit të dytë

spektatorët sovjetikë do të shikojnë edhe gjashtë filma të rini artistikë indianë, të mieshtëurve të kinematografisë indiane. Në filmin me dy seri «Zotnia 420», i cili tregon fatin tragjik të një njeriu të ri, i cili nuk mund të gjejë punë, ata do të shikojnë përsëri artistët e njohur Raxh

Kapur dhe Nargis. Filmi «Mirza Galib» paraqet jetën dhe veprimtarinë e poetit të madh indian të shekullit të XIX-të.

Dy filma «Muna» dhe «Dëshira» i kushtohen jetës së fëmijëve india-

Presidenti i Republikës së Libanit Kamil Shamun priti delegacionin e artistëve sovjetikë

Presidenti i Republikës së Libanit Kamil Shamun priti me 8 tetor në rezidencën e tij Beit Ed Din, delegacionin e artistëve sovjetikë, që gjëndën në Liban.

Ai u shprehu mirënjohien artistëve për vizitën në Liban dhe iu lut që t'i dërgojnë popullit sovjetik urimet e tij për suksese dhe lulëzim.

Kamil Shamun dekoroi kryetarin e delegacionit të artistëve sovjetikë ministrin e kulturës të RSS të Armenisë A.H. Shaëinian me urdhërin

Vizatime dhe piktura të fëmijve kinezë në R. D. Gjermane

Më se 500 modele, piktura, qindisje dhe artikuj të tjerë të punuar nga fëmijët, u dërguan më 28 tetor në republikën demokratike Gjermane për t'u ekspozuar në Berlin.

Të gjithë artikujt janë punuar dhe pregatitur nga fëmijë nën moshën 15 vjeç dhe përbëhen nga lloje kafshësh dhe bimësh, modele topografike, modele të urës mbi lumin Jagce në Vulhan, një observator meteorologjik në miniaturë dhe një kullë për hedhjet me parashutë.

Midis 200 artikujve artistikë, janë qindisja prej Hunanit, porcelana

Artistët kinezë korrin sukses të madh në Argjentinë

Ansambli artistik kinez që vizitoi Argjentinën u dha fund çfaqje-

në. Në programin e festivalit bëjnë pjesë filmat «Trashëgimtari» dhe «Biraxh Bahu».

Në ekrane do të çfaqen edhe një numur filmash dokumentarë indianë. Një delegacion i përfaqësonte të kinematografisë indiane i kryesuar nga zëvendës sekretari i ministrisë së informacionit dhe radiodifuzionit zoti S. Gopalan ka ardhur në Moskë i ftuar nga ministria e kulturës së Bashkimit Sovjetik për të marrë pjesë në festival.

më të lartë të Libanit «Për merita» të klasit të parë.

Në pritje ishin të pranishëm ambasadori i Bashkimit Sovjetik në Liban S.P. Kiktev.

Konçertet e artistëve sovjetikë në Liban po korrin një sukses të madh. Shtypi vë në dukje mieshtërinë e madhe të artistëve sovjetikë dhe shpreh dëshirën për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve kulturele midis Libanit dhe Bashkimit Sovjetik.

të punuara në Kingtehcon, figura prej allçije nga Ushih, dhe qindisje e kostume të kombësive Miao, Ji, mongole, tibetiane dhe Uigur.

Një portret i qëndisur me mjeshhtëri, e Ernest Telmanit, udhëheqës revolucionar i popullit gjerman, është punuar nga një nxënësi i shkollës fillore në Kansu, provinca Lançov.

Përveç këtyre përfshihen piktura, tradicionale kineze me bojra uji piktura me bojra vaji, piktura moderne me bojra uji, skica me penë dhe laps, vizatime me laps etj.

ve të tij në Buenos Aires. Çfaqja e fundit u transmetua nga shoqëria e

televizionit të Argjentinës.

Gazetat botojnë artikuj që lavdërojnë çfaqjet. Gazeta «La Nacion» i cilëson ato si një art të shkëlqyer. Gazeta «La Razon» thotë se opera e Pekinit ka qënë për publikun një çfaqje artistike e jashtëzakonshme dhe zbulim i një bote të cuditëshme.

Pritje për nder të delegacionit francez të kinematografisë në Kinë

Nënministri i kulturës Çan Çih Hsian dhe drejtori i byrosë kinematografike Van Lan Hsi, dhanë një pritje për nder të delegacionit francez të kinematografisë.

Çan Çih Hsian, i cili kryesoi delegacionin kinez të kinematografisë në Francë vitin e kaluar, tha se pjesëmarrja e delegacionit zyrtar francez të kinematografisë në festivalin e filmit francez në Pekin, është një

Çfaqjet e saj kanë qënë madhështore në këtë lloj të artit poetik, me thjeshtësinë teatrale dhe me fuqinë fizike.

Gjatë kohës që ishin këtu, anëtarët e ansamblit u takuan me artistët e argjentinës. Cu Tu Nan, kryetar i ansamblit, vizitoi shoqërinë kulture Argjentinë-Kinë.

ngjarje e rëndësishme në çkëmbimin kultural midis të dy vëndeve». Ai theksoi se ndërsa Kina është duke zhvilluar festivalin e filmit francez, një ekip akrobatësh kinezë, është duke dhënë çfaqje tani në Francë.

Andre Parent, kryetar i delegacionit të kinematografisë franceze, mburri sukseset e Kinës së re në industrinë e kinematografisë

Në Poloni filloi festivali i parë i muzikës moderne «Vjeshta e Varshavës»

Në Poloni filloi festivali i parë i muzikës moderne «Vjeshta e Varshavës».

Në festival marrin pjesë kolektiva muzikale, kompozitorë, solistë dhe muzikantë nga 19 vënde të botës, midis tyre nga Bashkimi Sovjetik, Republika popullore e Kinës, vëndet e demokracisë popullore, Britania, Austria, Franca, Italia, Suedia dhe Shtetet e Bashkuara.

Në Berlin u hap festivali i filmave të vëndeve të Demokracisë Popullore

Më 11 tetor në kinoteatrin «Babilon» të Berlinit u bë hapja solemne e festivalit të filmave të vëndeve të demokracisë popullore. Në ceremoni ishin mbledhur përfaqësues të kinematografisë, letërsisë dhe artit gjerman, përfaqësues të opinionit publik të Berlinit, anëtarë të trupit diplomatik.

Më 10 tetor në sallën e filarmonisë kombëtare në Varshavë u zhvillua ceremonia solemne e hapjes së festivalit.

Në koncertin e parë u egzekutuan simfonia e 10 e kompozitorit sovjetik D. Shostakovic dhe një aratorio e K. Shimanovskit. Në koncert mori pjesë orkestra simfonike e filarmonisë kombëtare poloneze nën drejtimin e B. Vodiçka.

Zëvendës drejtori i drejtorisë qendrore për çështjet e kinematografisë pranë ministrisë së kulturës të Republikës demokratike gjermane V. Harkental përshëndeti përfaqësuesit e kinematografisë të një numri vëndesh të demokracisë popullore, që kanë ardhur në Republikën demokratike gjermane për të marrë

pjesë në festival, V. Harkental njoftoi se gjatë festivalit në kinematë e Republikës demokratike gjermane, do të çfaqen filma artistikë kinezë, polakë, çekoslovakë, jugosllavë, rumunë, bullgarë dhe koreanë. Ai tha se gjatë pesë vjetëve të fundit në Republikën Demokratike Gjermane janë çfaqur 141 filma të vëndeve të demokracive popullore.

Duke theksuar se kinofestivali i tanishëm i shërben forcimit të mëtejshëm të lidhjeve kulturele midis

Republikës demokratike gjermane dhe vëndeve të demokracive popullore, V. Harkental theksoi rëndësinë e veçantë të pjesëmarrjes në festival të Republikës federative popullore të Jugosllavisë. Filmata jugosllavë tha ai, do të çfaqen për herë të parë në Republikën demokratike gjermane.

Pas mbarimit të ceremonisë zyrtare u çfaq filmi kinez «Karvani». Festivali vazhdoi gjer më 18 tetor.

10 vjetori i rihapjes së konservatorit të Lajpcigut

Një ceremoni solemne u zhvillua më 20 tetor në shkollën e lartë të muzikës në Lajpcig, konservatori i parë gjerman i themeluar nga Felix Mendelssohn Bertholdi më 1843, për nder të 10 vjetorit të rihapjes së saj, mbas luftës.

Shkolla mori me këtë rast telegrame urimesh nga presidenti Wilhelm Pik, kryetari i dhomës popullore dr. Dikman dhe nga kryeministri Oto Grotevol.

Që prej themelimit të tij, konser-

vatori i Lajpcigut ka tërhequr muzikantë nga anë të ndryshme të botës si përshëmbëll përmbi 2.000 studentë nga Britania, 2.000 nga Shtetet e Bashkuara dhe të tjerë.

Shkolla u dëmtua rëndë nga bombardimet më 1945, u rindërtua me përkrahjen e autoriteteve sovjetike të pushtimit dhe më vonë nga Republika demokratike gjermane. Që prej vitit 1946 shumë studentë të shkollës së lartë kanë arritur suksese të mbledha.

Korregjilm

Në Nëndorn Nr. 10 faqe 134 rreshti 39 të lexohet: e fshatrave. Mirpo parija....
faqe 188, rreshti 12 të lexohet: shmi mbi...
faqe 189, rreshti 7 të lexohet: pësëmbëdhjet vjet, ..